


PLANI OPERACIONAL

I ZHVILLIMIT LOKAL

BASHKIA BULQIZË



Mars, 2016

Plani Operacional i Zhvillimit Lokal (POZHL) është përgatitur nga Bashkia Bulqizë në kuadër të projektit STAR dhe zbatuar nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM).

Përgatitja e planit u udhëhoq nga bordi ‘Për Hartimin POZHL’ i kryesuar nga kryetari i bashkisë me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të administratës së bashkisë, të zyrës së arsimit, shëndetësisë, bujqësisë dhe përfaqësuesve të shoqërisë civile dhe biznesit.

Mbështetja dhe udhëheqja teknike u krye nga ekspertët e IDM:

Fation Dragoshi
Shefqet Bruka
Lorena Totoni

Grumbullimi i të dhënave, analizimi i tyre, si dhe përzgjedhja e prioriteteve dhe projekteve u krye nga:
Grupi i punës “Zhvillimi Ekonomik, Mirëqenia Sociale dhe Ekonomike” i kryesuar nga Ernela Novaku;
Grupi i punës “Burimet Natyrore, Mjedisi i Qendrueshëm dhe Zhvillimi Rural” i kryesuar nga Ylber Cami;
Grupi i punës “Infrastruktura dhe Shërbimet” i kryesuar nga Olsi Voka.

Përgatitja e planit u lehtësua dhe u mbështet nga koordinatori lokal Sulejman Keta.

Metodologjia në aspektin e barazisë gjinore u përgatit dhe monitorua nga Elona Dhëmbo, eksperte e PNUD.




Institute for Democracy and Mediation
Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim

PËRMBAJTJA

Parathënie	5
1. Nevoja e një plani Operacional Lokal	7
2. Plani operacional për Investimet në perspektivën e qeverisjes vendore dhe proceseve të planifikimit	9
3. Metodologjia e Planit Operacional të Zhvillimit Lokal	11
4. Diagnoza	13
4.1 Të dhënat kryesore / kyç rreth Bashkisë	13
4.2 Zhvillimi ekonomik	14
4.3 Mirëqenia sociale dhe ekonomike	17
4.4 Burimet natyrore dhe mjedisi i qëndrueshëm	19
4.5 Infrastruktura dhe shërbimet	23
5. Përcaktimi i problemeve dhe prioriteteve afat-shkurtra operationale	25
6. Plani operacional	29
7. Plani POZHL në kuadër të planifikimit strategjik dhe territorial	37
8. Anekset	38
Aneks 1	
Kritere vlerësimi për identifikimin e projekteve prioritare	38
Aneks 2	
Fishë projektet	39

Parathënie



Dokumenti që po ju prezantojmë vjen si një sukses i parë i administratës së re të Bashkisë Bulqizë në fushën e planifikimit dhe zhvillimit vendor duke përcaktuar vizionin, prioritetet operacionale dhe projektet e bashkisë. Plani, nga njëra anë është një dokument i rëndësishëm në fushën e planifikimit dhe shfrytëzimit me efektivitet e efikasitet të burimeve financiare, njerëzore, natyrore dhe të aseteve të bashkisë, por nga ana tjetër ai gjithashtu nxit dhe vë si detyrë hartimin dhe miratimin e dokumentave të tjerë të planifikimit e zhvillimit të bashkisë, si të strategjisë për zhvillimin e integruar, planin e përgjithshëm vendor,

strategjinë e zhvillimit bujqësor dhe rural etj.

Plani Operacional i Zhvillimit Lokal është hartuar me kontributin e të gjithë aktorëve në territor dhe me këtë rast dua të falënderoj përfaqësuesit e administratës së Bashkisë Bulqizë të përfshirë në këtë proces, përfaqësuesit e institucioneve të dekoncentruara, komunitetin sipërmarrës dhe shoqërinë civile.

Shpreh vlerësimin dhe falenderimin tim për punën e mirë të bordit “Për Hartimin POZHL” dhe të tre grupeve të punës që realizuan grumbullimin e të dhënave dhe analizimin e tyre, si dhe finalizuan përzgjedhjen e prioriteteve dhe të projekteve.

Gjej rastin të falënderoj Institutin për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) për mbështetjen dhe ekspertizën e lartë të ofruar gjatë gjithë procesit të hartimit të planit.

Falenderime të veçanta shkojnë për projektin STAR dhe për Ministrin e Shtetit për Çështjet Vendore, të cilët mbështetën dhe mundësuan hartimin e këtij plani.

Melaim DAMZI

Kryetari i Bashkisë Bulqizë

1.

Nevoja e një Plani Operacional Lokal

Plani Operacional i Zhvillimit Lokal (POZHL) është hartuar në kuadër të zbatimit të reformës administrativo-territoriale, me nismën e Ministrit të Shtetit për Çështjet Vendore dhe mbështetur nga projekti STAR (Support to Territorial and Administrative Reform). POZHL vjen si një nevojë dhe sfidë e menjëhershme e bashkive për të integruar strategjitë dhe planet e ndryshme të veprimit e zhvillimit, si dhe për të siguruar një kohezion administrativo-territorial të bashkimit të territorit. Reforma administrativo-territoriale u mundësoi bashkive pasjen në dizpozicion të më shumë aseteve dhe burimeve njerëzore e financiare, duke mbartur sakaq një numër të konsiderueshëm çështjesh e problemesh të ish-njësisve vendore. Këto të fundit lidhen kryesisht me mungesën e efektivitetit dhe efikasitetit, mungesën e kapaciteteve, si dhe psikologjinë e planifikimit dhe organizimit të shërbimeve në territore të vogla e të ndara. POZHL i ofron ndihmë bashkive për të shfrytëzuar potencialet e reformës së konsolidimit territorial, si dhe për të lehtësuar tejkalimin e problemeve të mbartura nga ish-njësitë.¹

Në përputhje me nenin 28 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Bashkia Bulqizë ka hartuar planin operacional të zhvillimit lokal si një instrument drejtimi afatshkurtër i bashkisë në fushën e planifikimit dhe zhvillimit lokal.

POZHL synon të ndihmojë bashkinë në:

- identifikimin e diagnostikimin e gjendjes së zhvillimit lokal në territorin e ri të saj, që para qershorit 2015 ishte i ndarë në 8 njësi;
- përcaktimin e vizionit dhe perspektivës së zhvillimit afatshkurtër;
- identifikimin e drejtimeve dhe prioriteteve operacionale si dhe të projekteve prioritare;
- mobilizimin e aseteve, burimeve njerëzore e financiare në dobi të zhvillimit lokal me synim përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve të Bulqizës.

¹ http://www.parlament.al/web/pub/raporti_final_permbledhje_ekzekutive_28_prill2014_16984_1.pdf

POZHL ka një rëndësi thelbësore për investimet afatshkurta të bashkisë pasi:

- do të lidhet me vizionin e bashkisë dhe do t'i paraprijë proceseve të tjera të planifikimit e zhvillimit të bashkisë, duke përfshirë strategjinë e zhvillimit të integruar, planin e përgjithshëm vendor, strategjinë e zhvillimit bujqësor dhe rural, zhvillimin dhe menaxhimin e turizmit, mjedisit etj.
- do të krijojë një platformë për shfrytëzimin me efektivitet dhe efikasitet të burimeve financiare e njerëzore;
- do të krijojë sinergji me hartimin e buxhetit të parë vjetor të bashkisë, duke ofruar një instrument për të kryer "gjërat" që duhen dhe siç duhen, si dhe duke lehtësuar thithjen e investimeve të brendshme dhe të huaja;
- do të jetë një referencë e rëndësishme e bashkisë në proceset e planifikimit, aplikimit dhe zbatimit të projekteve me fonde të qeverisë, BE-së, si dhe me fonde të gjeneruara nga partneriteti publik-privat;
- do të përbëjë një bazë të mirë për marrëveshjet e bashkëpunimit ndërvendor, sidomos në fushat e ofrimit të shërbimeve, si në fushën e furnizimit me ujë, transportit, menaxhimit të mbetjeve urbane;
- do të orientojë dhe do të nxisë krijimin e subjekteve që ofrojnë shërbime në të gjithë territorin e bashkisë, duke përmirësuar dhe rritur shkallën e planifikimit me qasje territori të integruar të bashkisë.

2.

Plani operacional për investimet në perspektivën e qeverisjes vendore dhe proceseve planifikuese

Plani Operacional për Investimet (kapitulli 6) përfaqëson një nga elementët kryesorë të POZHL. Ai është një plan investimesh 2-3 vjeçarë, i cili identifikon projektet që do të zbatohen, grupet e synuara, periudhën e zbatimit, kostot, burimin e financimit, përgjegjësit për zbatimin dhe impaktin e pritshëm.

Në hartimin e planit të investimeve u morën parasysh disa elementë të rëndësishëm si:

- plani qeverisës i kryetarit të bashkisë i premtuar gjatë fushatës elektorale dhe i votuar në qershor 2015 nga qytetarët e Bashkisë Bulqizë;
- nevojat dhe prioritetet e qytetarëve nga njëra anë dhe kapacitetet e mundësitë financiare të bashkisë për investime nga ana tjetër;
- mundësitë e ndërveprimit dhe partneritetit të bashkisë me komunitetin, donatorët, programet e ndryshme të zhvillimit (Fondi i Rajoneve, projektet e bashkëpunimit ndërkufitar etj.);
- perspektiva e qeverisjes vendore e saksionuar në dokumentat strategjike kombëtarë: (i) objektivi numër 2 i reformës administrativo-teritoriale dhe (ii) qëllimet strategjike numër 2 dhe 3 të Strategjisë Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2015–2020;
- kriteret e vlerësimit për identifikimin e projekteve prioritare të miratuar nga bordi “Për hartimin POZHL”.

Plani i investimeve, si një pjesë integrale e POZHL, mund të përditësohet çdo vit me miratimin e buxhetit. Ai mbart disa avantazhe në drejtim të perspektivës së bashkisë dhe të proceseve të planifikimit pasi:

- orienton vëmendjen tek prioritetet, nevojat dhe mundësitë financiare të bashkisë në investime;
- ndihmon bashkinë në rritjen e qendrueshmërisë financiare dhe mirë-menaxhimin e burimeve financiare;
- siguron transparencën në fondet për investime;
- përmirëson bashkëpunimin dhe komunikimin midis stafit të bashkisë dhe aktorëve të tjerë në territor;
- përmirëson infrastrukturën, e cila në mënyrë të drejtpërdrejtë mundëson edhe përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve.

Ka një angazhim të fortë të Bashkisë Bulqizë ndaj realizimit të planit të investimeve përmes një plani detyrash të mirëpërcaktuara nga kryetari i bashkisë. Disa nga këto detyra afatshkurtra (100 ditët e para) që do të lehtësojnë dhe krijojnë infrastrukturën e domosdoshme për realizimin e planit të investimeve janë:

- përmirësimi i kapaciteteve financiare të bashkisë nëpërmjet riorganizimit të strukturës administrative të taksë-tatimeve, përmirësimit të paketës financiare, si dhe të vjeljes së rentës minerare;
- ngritja e strukturës administrative për hartimin dhe zbatimin e projekteve dhe rritja e kapaciteteve të saj;
- studimi i mundësisë së ngritjes të një agjencie për zhvillimin vendor apo të praktikave të zhvillimit vendor të udhëhequr nga komuniteti (CLLD),¹ siç janë grupet lokale të veprimit;
- miratimi i rregullores dhe i instrumentave të pjesëmarrjes së komunitetit në planifikimin dhe zhvillimin vendor;
- riorganizimi i administratës së bashkisë dhe rritja e vazhdueshme e kapaciteteve të saj;
- krijimi i instrumentave të ndërveprimit dhe partneritetit me sipërmarrësit privat dhe shoqërinë civile;
- miratimi i rregullores së transparencës dhe të monitorimit financiar;
- hartimi i paketës së parë të projekteve zhvillimore dhe aplikimi në thirrjet e radhës nga Fondi për Zhvillimin e Rajoneve, projektet e bashkëpunimit ndërkufitar me Kosovën dhe Malin e Zi në kuadër të programit IPA, programi Italo-Shqiptar i Konvertimit të Borxhit për Zhvillim (IADSA) dhe donatorë të tjerë.

1 Community-led Local Development (CLLD).

3.

Metodologjia e Planit Operacional të Zhvillimit Lokal

Metodologjia e ndjekur kombinoi informacionet prej burimeve parësore dhe dytësore, me ngritjen e strukturave udhëheqëse dhe analizuese, si dhe përdorimin e metodës 4R (Representation-perfaqesimi, Resources-burimet, Realia-analizimi i kushteve, Realisation-zbatimi) për aspektin e barazisë gjinore. Nëpërmjet kësaj metodologjie dhe në referencë të vizionit dhe nevojave vendore, u synua t’u jepej autoriteteve dhe komunitetit një instrument drejtimi afatshkurtër në fushën e planifikimit dhe zhvillimit lokal. Metodologjia synoi gjithashtu aftësimin e autoriteteve vendore në formulimin, drejtimin dhe monitorimin e POZHL, përmirësimin e kapaciteteve njerëzore e teknike, si dhe sigurimin e ndjenjës së “pronësisë” tek komuniteti dhe të gjithë aktorët në procesin e planifikimit dhe zhvillimit.

Për realizimin e synimit të sipërcituar u ngrit bordi “Për hartimin POZHL” i kryesuar nga kryetari i bashkisë. Bordi përbëhej nga 10 anëtarë që vinin nga zyrat kryesore të bashkisë, administratorë të njësive administrative, drejtues të zyrave të arsimit, shëndetësisë, bujqësisë, përfaqësues të shoqërisë civile dhe të biznesit. Bordi udhëhoqi procesin, miratoi ngritjen e grupeve të punës, kriteret për vlerësimin dhe identifikimin e projekteve prioritare, vizionin dhe perspektivën e zhvillimit të bashkisë dhe miratoi POZHL.

Me qëllim grumbullimin e të dhënave dhe analizimin e tyre, diagnostikimin e problemeve dhe përzgjedhjen e projekteve prioritare, u ngritën tre grupe pune:

- Zhvillimi ekonomik, mirëqenia sociale dhe ekonomike;
- Burimet natyrore, mjedisi i qendrueshëm dhe zhvillimi rural;
- Shërbimet dhe infrastruktura.

Informacioni për përgatitjen e POZHL u mblodh duke përdorur të dhëna parësore dhe dytësore. Si burim të dhënash parësore shërbyen intervistat gjysmë të strukturuar me ekspertë dhe zyrtarë të qeverisjes vendore, OJQ vendore, përfaqësues të institucioneve të dekoncentruara, biznesin vendas etj. Intervistat synuan të prekin problematikat që lidhen me

të sotmen dhe të ardhmen e zhvillimit të Bulqizës, duke aktivizuar dhe përfshirë potencialet më të mira intelektuale me qëllim arritjen e një konsensusi sa më të gjerë dhe të një ndjenje pronësie mbi gjithë procesin. Si burim të dhënash dytësore u përdorën: (i) dokumenta strategjikë, si Strategjia e Zhvillimit Rajonal 2012-2016, Plani i Zhvillimit të Qendrushëm të Komunitetit të Bulqizës 2012-2030, Instrumenti i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Bulqizë i miratuar me vendim nr.12, datë 07.03.2014 të Këshillit Kombëtar të Territori, Strategjia e Promovimit të Mineraleve të Shqipërisë, Plani i Menaxhimit të Peizazhit të Mbrojtur Mali me Gropa-Bizë-Martanesh; (ii) të dhëna nga INSTAT, Autoriteti Kombëtar i Rrugëve, Ministria e Ekonomisë, zyrat e bashkisë, arsimit, shëndetit, pyjeve etj.

U përdor metoda e “Analizës së pemës së problemit”, e cila përfshin përcaktimin e problemeve kryesore dhe krijimin e lidhjeve shkak-pasojë-problem-efekt. Ndërkohë, për përcaktimin e objektivave dhe prioriteteve operacionale u përdor “Pema e objektivave ose e zgjidhjeve” që në thelb është vazhdim i pemës së problemeve.

Për formulimin e vizionit, drejtimeve strategjike dhe perspektivës së zhvillimit u organizua një workshop, ku morën pjesë përfaqësues të bashkisë, të shoqërisë civile dhe intelektualë të zonës, nga ku u përcaktuan dhe drejtimet kryesore të zhvillimit, prioritetet operacionale dhe masat përkatëse për realizimin e tyre.

Për grumbullimin dhe analizimin e të dhënave, diagnostikimin e problemeve, përcaktimin e objektivave, prioriteteve dhe projekteve prioritare në aspektin e barazisë gjinore u përdor metoda 4R¹ e hartuar dhe monitoruar nga ekspertët e PNUD.

Drafti i POZHL u konsultua me grupe të interesit nga bashkia, njësitë administrative, zyrat e arsimit, shëndetësisë, bujqësisë, shoqëria civile dhe biznesi, specialistë dhe qytetarë.

¹ Metoda origjinale u zhvillua rreth fundit të viteve 1990 në një projekt të Shoqatës Suedeze të Autoriteteve Lokale të quajtur JämStod.


4.

Diagnoza

4.1 Të dhënat kryesore/kyç rreth Bashkisë

Bashkia Bulqizë ndodhet në lindje të Shqipërisë dhe është pjesë e qarkut Dibër. Ajo kufizohet në veri me Bashkinë e Dibrës, në perëndim me Bashkinë Klos, në jug-perëndim me Bashkinë Tiranë, në jug me Bashkinë Librazhd dhe në lindje me Republikën e Maqedonisë.

Bashkia shtrihet në një territor prej 678.51 km² dhe në përbërjen e saj ka 8 njësi administrative (Bulqizë, Martanesh, Fushë-Bulqizë, Zerqan, Shupenzë, Gjoricë, Ostren dhe Trebisht), 2 qytete (Bulqiza dhe Krasta) dhe 63 fshatra.² Sipas Censurit (2011), popullsia është 31 210 banorë me dendësi sipas ndarjes së re territoriale 25.7 banorë për km², ndërkohë sipas gjendjes civile bashkia ka 40 223 banorë.³ Qendra e bashkisë është qyteti i Bulqizës.



Relievi është përgjithësisht terren i thyer malor, me lartësi që shkojnë nga 420 m në 2101 m në majën e Kreshtës në jug të maleve të Allamanit. Territori përshkohet nga lumenjtë Zalli i Bulqizës (degë e Drinit të Zi), Zalli i Okshtunit që ushqen Zallin e Bulqizës, lumi Mat etj. Në lartësitë 1500-1700m gjenden liqene të shumta akullnajore, ku më të përmendurit janë Liçeni i Zi, Liçeni i Balgjajve etj.

² Ligj Nr. 115/2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”.

³ Evidenca e gjendjes civile datë 27.10.2015.

Territori është shumë i pasur me burime ujore nëntokësore dhe ka potenciale hidroenergjitike.

Klima është kontinentale e ftohtë në dimër dhe e thatë në verë. Temperatura mesatare vjetore arrin vlerën 10°C. Temperatura maksimale e regjistruar ka qenë 35°C, ndërsa ajo minimale -18°C.

Bimët mjekësore janë shumë të përhapura. Sipërfaqja e tokës bujqësore nuk është e madhe dhe gjendet në shpate të pjerrëta. Ushtrohen bujqësia dhe blegtoria. Zona është shumë e pasur me pyje të pishës e të ahut, të cilët mbulojnë një sipërfaqje rreth 36 mijë ha. Problemet mjedisore lidhen me sistemimin e ujërave të zeza dhe përpunimin e mbeturinave urbane.

Në Bulqizë dhe në Krastë gjenden vendburimet më të mëdha në Shqipëri të mineralit të kromit, të cilat së bashku me pyjet përbëjnë bazën kryesore të zhvillimit ekonomik. Qytetet e Bulqizës dhe Krastës janë qytete të ndërtruara në funksion të aktivitetit të nxjerrjes dhe përpunimit të mineralit të kromit, i cili megjithë kushtet jo optimale të punës në miniera përbën burimin kryesor të punësimit në zonën e karakterizuar nga papunësia e lartë. Turizmi malor dhe përpunimi i bimëve mjekësore përbën gjithashtu një mundësi të mirë zhvillimi.

Trashëgimia kulturore dhe etnografike është e pasur. Në zonën e Gollobordës është i pranishëm komuniteti maqedonas që ruan gjuhën dhe kulturën e vet.

Aksesi dhe transporti janë lehtësuar nga përmirësimi i infrastrukturës rrugore në segmentin e rrugës nacionale "Qafa e Buallit- Shupenzë", pjesë e Rrugës së Arbërit, si dhe hapja e tunelit dhe trasesë Qafa e Buallit-Ura e Vashës.

Organet përfaqësuese dhe ekzekutive të bashkisë janë: (i) këshilli bashkiak, i përbërë nga 21 anëtarë, 18 meshkuj dhe vetëm 3 femra (14.3%). Anëtarët vijnë nga 17 subjekte të ndryshme politike të grupuar në dy aleanca parazgjedhore: Aleanca për Shqipërinë Europiane (ASHE) me 13 anëtarë dhe Aleanca Popullore Për Punë dhe Dinjitet (APPD) me 9 anëtarë; (ii) Kryetari i Bashkisë, Melaim Damzi, i zgjedhur në qershor 2015 në emër të koalicionit ASHE; dhe (iii) administrata bashkiake, e përbërë nga 248 punonjës, nga ku 138 janë femra.

4.2 Zhvillimi ekonomik

Bashkia ka në funksionet e veta hartimin dhe zbatimin e programeve për zhvillim ekonomik vendor. Megjithatë, zhvillimi vendor nuk mbetet përgjegjësi e një aktori të vetëm, por kërkon një ndërveprim dhe partneritet të detyrueshëm midis aktorëve të ndryshëm në territor, duke përfshirë qeverisjen vendore, institucionet e dekoncentruara, komunitetin sipërmarrës dhe shoqërinë civile.

Në ish-NJQV-të janë përdorur disa strategji apo plane zhvillimi, si Strategjia e Zhvillimit Rajonal 2012-2016, Plani i Zhvillimit të Qendrueshëm të Komunitetit të Bulqizës 2012-2030, Instrumenti i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Bulqizë, i miratuar me vendim nr. 12, datë

07.03.2014 të KKT,⁴ Strategjia e Promovimit të Mineraleve të Shqipërisë, Plani i Menaxhimit të Peisazhit të Mbrojtur Mali me Gropa-Bizë-Martanesh. Në asnjë nga ish-NJQV-të pjesë përbërëse të bashkisë Bulqizë nuk ka patur agjenci të zhvillimit vendor, apo praktika të zhvillimit vendor të udhëhequra nga komuniteti, siç janë grupet lokale të veprimit.

Për analizën demografike janë përdorur disa tregues që lidhen me potencialet demografike, tendencën e popullsisë, si dhe burimet njerëzore. Sipas Censusit (2011) bashkia ka 31 210 banorë, ndërsa sipas regjistrit të gjendjes civile 40 223 banorë.⁵ Fëmijët ose grupmosha 0-14 vjeç përbëjnë 26% të popullsisë, popullsia e aftë për punë (grupmosha 15-64 vjeç) 65.6%, ndërkohë të moshuarit 8.3%. Gratë përbëjnë 49.6% të popullsisë dhe 12.8% e familjeve drejtohen nga kryefamiljare femra (INSTAT, 2011). Në periudhën 2001-2011, tendenca e popullsisë ka qenë në ulje. Si rezultat i migrimit të brendshëm dhe të jashtëm ka një shpopullim prej 27.36%. Tkurrja më e madhe vihet re në Martanesh (48.22%) ndjekur nga Ostreni (37.51%). Rënien më të vogël e ka përjetuar Fushë-Bulqiza me 19.59%. Megjithatë, tendenca e shpopullimit të bashkisë paraqitet më e vogël se tendenca në nivelin qarku (27.8%).

Përsa lidhet me nivelin arsimor, në bashki ka një numër më të vogël individësh me arsim të mesëm dhe me arsim të lartë në krahasim me qarkun dhe me vendin (shih Kapitullin 4.3).

Bashkia shtrihet në një territor prej 67 551 ha, nga ku 8 750 ha janë tokë bujqësore. Në dekadën e fundit, njësitë të qeverisjes vendore u janë transferuar 18 578.8 ha pyje, 5057.2 ha kullota, 6 505 ha inproduktive dhe 114.8 ha sipërfaqe ujore. Sipas ndarjes administrative, bashkia klasifikohet në 26.9% urbane dhe 73.1 % rurale, ndërsa sipas rrjetit të qelizave⁶ në nivel njësie vendore klasifikohet si 22.8% urbane dhe 77.2% rurale.

Që prej vitit 2002 numri i ndërmarrjeve aktive jo-bujqësore ka pësuar një rritje të konsiderueshme. Në 2010 Bulqiza kishte 601 ndërmarrjeve aktive jo-bujqësore⁷ ose 19 sipërmarrje për 1000 banorë. Në zyrën e punës për vitin 2015 janë deklaruar 108 subjekte, prej të cilave 32 janë shtetërore dhe 76 në sektorin privat (9 persona fizikë, 67 persona juridikë). Peshën kryesore e mban tregtia, ndjekur nga shërbimet dhe transporti. Në fushën minerare veprojnë 119 subjekte.

Bashkia ka kapacitete të ulëta financiare. Në vitin 2012 vetëm 21.9% e buxhetit vinte nga taksat dhe tarifatat vendore, ndërsa 78.1% nga transfertat e pakushtëzuara. Kapacitet më të mirë financiar paraqet ka ish-njësia Bulqizë. Në projektligjin për buxhetin e vitit 2016 janë parashikuar transfertat të pakushtëzuara në shumën e 217 081 000 lekë, nga ku jo më pak se 40% e saj duhet të përdoren për investime.

Zhvillimi ekonomik është i orientuar në bujqësi, blegtori dhe industrinë minerare. Ka potenciale zhvillimi në turizëm dhe në grumbullimin e bimëve mjekësore. Bujqësia është e organizuar në ferma të vogla familjare, sipërfaqja e tokës së punueshme është e vogël, e copëzuar dhe terreni është i pjerrët. Zona ka klimë të përshtashme për zhvillimin e bimëve

⁴ Këshilli Kombëtar i Territorit.

⁵ Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile Tiranë, Janar 2014

⁶ INSTAT. Një klasifikim i ri urban – rural i popullsisë shqiptare.

⁷ Strategjia e Zhvillimit Rajonal 2012-2016.

të arave, foragjereve, frutikulturës, vreshta, arrorë etj. Në disa ish-njësi shihet me interes nxitja e banorëve të komunës për mbledhjen dhe grumbullimin e prodhimeve të gështenjës dhe arrorëve. Rreth 34.5% e të punësuarve janë të angazhuar **në sektorin e bujqësisë**.⁸

Një pjesë e konsiderueshme e tokës bujqësore nuk është e ndarë sipas ligjit për tokën. Sistemi i ujitjes është i amortizuar dhe në shumë ish-njësi është jashtë përdorimit. Mungon infrastruktura e grumbullimit, paketimit dhe përpunimit të produkteve bujqësore. Skema e menaxhimit dhe mirëmbajtjes së infrastrukturës së ujitjes vlerësohet si e papërshtashme. Fermat janë shumë të fragmentizuara dhe prodhimi kryesisht plotëson nevojat familjare, mbisundon mentaliteti individual dhe mungojnë qasjet e punës në grup.

Kushtet natyrore të bashkisë favorizojnë rritjen e deleve, dhive, gjedhëve dhe bletëve. Në disa njësi administrative blegtoria është aktiviteti kryesor e ekonomisë. Megjithatë, nuk ekzistojnë të gjitha hallkat e zinxhirit të prodhimit për produktet blegtorale. Mungesa e baxhove, infrastruktura e papërshtashme, promovimi i dobët, mungesa e markës dhe emigrimi i krahut të punës shihen si veçanërisht shqetësuese nga disa blegtorë. Në qendër të njësisë administrative, çdo të dielë organizohet Tregu i Madh (Pazari), ku bëjnë tregti banorët vendas por edhe nga njësitë e tjera të Bulqizës, Dibrës dhe Matit.

Industria minerale është dega kryesore e ekonomisë në dy njësi administrative (Bulqizë dhe Martanesh). 119 subjekte të fushës minerare ushtrojnë aktivitetin në zonë, nga ku 112 me leje shfrytëzimi, 4 me leje kërkim zbulimi dhe 3 me leje zbulimi. Sasia e përgjithshme e rezervave të mineralit të kromit në masivin Bulqizë-Bater i klasifikuar sipas KNR⁹ rezulton të jetë 10 080 507 ton. Miniera më e madhe është ajo e Bulqizës, ku ndodhen rreth 41% e rezervave. Në sektorin e industrisë punojnë 28.7% e të punësuarve.¹⁰ Në njësinë Shupenzë ka burime të mineralit të mermerit.

Në livadhet dhe pyjet me dushk, ah, pishë të zezë e të bardhë të Bulqizës gjendet një florë e pasur dhe e larmishme me bimë mjekësore dhe aromatike, si dëllinja e kuqe dhe e zezë, trëndafili i egër, çaji i malit, lule bliri, zhumblica, mëllaga, lule basani, lule shtogu etj. Në dekadën e fundit pothuajse të gjithë ish-njësitë e qeverisjes vendore kanë pasur si objektiv të tyre mbështetjen e individëve dhe subjekteve që merren me grumbullimin dhe tregtimin e bimëve medicinale, aromatike dhe industriale. Për shkak të kapaciteteve të ulëta financiare, ky synim nuk ka gjetur mbështetje. Aktualisht, mënyra e mbledhjes së bimëve nuk respekton periudhën e mbledhjes, metodologjinë dhe sasinë e bimëve, si dhe ka mungesë informacioni në lidhje me speciet kryesore dhe dendësinë e bimëve në zonë.

Në dekadën e fundit, turizmi është parë si një mundësi për zhvillimin ekonomik të zonës nga të gjithë ish-njësitë vendore. Pavarësisht se të gjitha njësitë kishin në vizionin, synimet dhe projektet tyre, zhvillimin e turizmit, ai mbetet në hapat e para të zhvillimit të tij për shkak të infrastrukturës së papërshtatshme, promovimeve të pakta të vlerave turistike të zonës, mungesës së kushteve të akomodimit të turistëve, mungesës së qendrave të informacionit turistik, ciceronëve, tabelave në territor etj.

⁸ <http://instatgis.gov.al/#/l/prefectures/population/prefpop1>

⁹ Klasifikimi Ndërkombetar i Rezervave, Strategjia e promovimit të mineraleve të Shqipërisë.

¹⁰ <http://instatgis.gov.al/#/l/prefectures/population/prefpop1>

4.3 Mirëqenia sociale dhe ekonomike

Diagnoza e mirëqenies sociale dhe ekonomike është komplekse për shkak të shumëllojshmërisë së treguesve që duhen shqyrtuar dhe hera-herës edhe të mungesës së të dhënave të besueshme. Në këtë aspekt u përfshinë disa tregues të mirëqenies sociale që janë pjesë përbërëse e treguesit “Të jetosh mirë” si dhe tregues të mirëqenies ekonomike.

Në lidhje me arsimin e mesëm, universitar dhe pasuniversitar, bashkia ka tregues të ulët të nivelit arsimor të përfunduar në krahasim me qarkun dhe me vendin.¹¹ Rreth 22.7% e popullsisë 15 vjeç e lart ka përfunduar arsimin e mesëm (të përgjithshëm ose profesional), ndërkohë rreth 4.0% ka përfunduar arsimin universitar ose pasuniversitar (në krahasim me 24.26% dhe 5.2% në nivel qarku dhe 31.4% dhe 11.8% në nivel vendi). Në arsimin parashkollor për vitin 2015-2016 janë regjistruar 955 fëmijë me 55 mësues. Arsimi parauniversitar (niveli fillor dhe i mesëm i ulët) ndiqet nga 4446 nxënës, 2020 janë vajza (45.4%) dhe 2426 janë djem (54.6%). Në këtë nivel arsimor japin mësim 328 mësues, ku 64.9% janë femra. Gratë drejtuese janë 34.5%. Niveli i mësimdhënies është më i lartë në shkollat e qytetit të Bulqizës dhe si rrjedhojë nxënës nga njësia administrative Zerqan dhe Fushë Bulqizë ndjekin mësimin në këto shkolla. Në arsimin parauniversitar (niveli i mesëm i lartë) janë regjistruar 1184 nxënës, 577 vajza (48.7%) dhe 607 djem (51.3%). Në këtë nivel arsimor japin mësim 72 mësues (61% janë mësuese). Gratë drejtuese janë 25%. Në shkollat e mesme të qytetit të Bulqizës ndjekin mësimin nxënës nga të gjithë njësitë administrative të Bulqizës.

Shërbimi shëndetësor në Bulqizë është kryesisht publik, me përjashtim të shërbimit farmaceutik dhe stomatologjik. Shërbimi publik i ofron popullatës pjesën më të madhe të shërbimeve shëndetësore, si në fushën e parandalimit, diagnostikimit dhe kurimit. Në shërbimin parësor shërbejnë 18 mjekë dhe 160 infermiere. Në shërbimin spitalor ka mungesë të specialistëve kirurg, reanimator, obstetër-gjinokolog, peditër, kardiolog etj. Shërbimi farmaceutik mbulohet nga 8 farmaci, 5 në zonën urbane dhe 3 në zonën rurale. Shërbimi stomatologjik ofrohet nga 6 klinika (5 private dhe 1 shtetërore), por kërkohet shërbimi stomatologjik në shkollat me shumë nxënës.

Për tremujorin e tretë të 2015, sipas zyrës së punës janë të punësuar 3 525 punonjës. Numri më i madh i të punësuarve është i angazhuar në sektorin privat (rreth 71.9%), ku peshën kryesore e mbajnë 67 subjekte juridike me 71.2% të të gjithë të punësuarve. Individët me nivel arsimor fillor dhe 8/9-vjeçar janë më të punësuarit (55.2%), ndjekur nga kategoria me arsim të mesëm e profesional (32.5%) dhe ajo me arsim universitar (11.7%).¹² Në zonën urbane¹³ kategoria më e punësuar është ajo me arsim të mesëm dhe profesional, ndjekur

¹¹ Po aty.

¹² <http://instatgis.gov.al/>

¹³ Klasifikimi administrativ.

nga kategoria me universitet. Shërbimet mbajnë peshën kryesore të të punësuarve (36.7%) ndjekur nga bujqësia (34.5%) dhe industria (28.7%). Shkalla e punësimit të grave është në shifrat më të ulëta në vend.¹⁴ Vetëm 17.4% e grave të grupmoshës 15-64 vjeç janë të punësuar. Shkallë e papunësisë është më e lartë nëse krahasohet me nivelin kombëtar.¹⁵ Rreth 38.5% e forcës së punës 15 vjeç e lart është e papunë. Niveli i papunësisë së grave dhe të rinjve është veçanërisht shqetësues. Rreth 37.4% e grave janë të papuna (në nivel qarku 34.9% dhe në nivel vendi 31.4%). Ndërkohë, papunësia tek të rinjtë e moshës 15-24 vjeç arrin në 64.3%. Të dhënat administrative nga zyra e punës Bulqizë tregojnë se peshën kryesore të papunësisë e mbajnë punëkërkuesit që përfitojnë ndihmë ekonomike. Rreth 35.3% e punëkërkuesve të papunë janë kryefamiljarë. Koeficienti i varësisë së përgjithshme¹⁶ është 52.36% kundrejt 47.1% në shkallë vendi.

Burimi i të ardhurave të njësisë ekonomike familjare në Bulqizë është puna e paguar ose vetëpunësimi me 41.2%. Një peshë të lartë në burimin e të ardhurave mbajnë pensionet me 34.7% dhe ndihma sociale dhe përfitimet me 31.1%. Remitancat zënë 8.7% të burimit të të ardhurave¹⁷.

Për banesat me ujë, bashkia ka tregues të ulët në krahasim me qarkun dhe me vendin.¹⁸ 61.4% janë banesa me ujë brenda kundrejt 66% në rang vendi. Banesa pa asnjë lloj sistemi furnizimi me ujë janë 4% krahasuar me 2.7% në rang vendi. Furnizimi me ujë të pijshëm i popullsisë që mbulohet nga Sh.A Ujsjellësi është 6-9 orë në ditë¹⁹, një tregues larg standarteve dhe objektivave të vendosura në Strategjinë Kombëtare të Furnizimit me Ujë 2011-2017.

Ndër programet sociale mund të përmendim: (i) programin e ndihmës ekonomike, nga i cili për periudhën shtator-tetor 2015, përfitonin 2207 familje ose 37.3% e familjeve të Bulqizës (237 me ndihmë të plotë dhe 1970 me ndihmë të pjesshme). 245 familje me kryefamiljarë gra trajtohen me ndihmë ekonomike, për të cilat deri në tetor 2015 janë shpenzuar 102 847 000 lekë; (ii) programin e pensioneve të pleqërisë ,nga i cili përfitojnë 6 158 persona ose 19.7% e personave të grupmoshës 15 vjeç e lart.

Një nga treguesit për matjen e mirëqenies ekonomike është PBB. Për të pasqyruar këtë tregues u përdorën të dhënat e publikuara nga INSTAT sipas Nomenklaturës së Njësisive Territoriale për Statistikat (NUTS) për nivelin 1, 2, dhe 3 dhe jo nivelit LAU 1 apo 2, pasi INSTAT ende nuk ka publikime për këto nivele. Bashkia Bulqizë si pjesë përbërëse e rajonit të veriut (NUTS 2), ka PBB-në me çmime korrente²⁰ më të ulët se dy rajonet e tjera (qendra dhe jugu); qarku i Dibërës (NUTS 3) ka PBB-në me çmime korrente më të ulët se tre qarqet e tjera (Shkodër, Lezhë, Durrës) dhe më të lartë se qarku i Kukësit. PBB për frymë është me

¹⁴ Po aty.

¹⁵ Census (2011).

¹⁶ <http://instatgis.gov.al/>

¹⁷ <http://instatgis.gov.al/#!/1/prefectures/population/prefpop1>

¹⁸ <http://instatgis.gov.al/>

¹⁹ Plani i zhvillimit të qendrueshëm të komunitetit të Bulqizës.

²⁰ INSTAT. (2014). "Prodhimi i Brendshëm Bruto sipas Rajoneve Statistikore në Shqipëri, 2012"

ulët në qarkun e Dibrës krahasuar me katër qarqet e tjera të njëjtit rajon. Ndërkohë, rajoni i veriut ka treguesin më të ulët të PBB-së për frymë se dy rajonet e tjera. Në të njëjtën linjë është edhe Standardi i Fuqisë Blerëse.

4.4 Burimet natyrore dhe mjedisi i qendrueshëm

Bulqiza është një zonë e pasur me burime natyrore, ku vendin kryesor e zënë pyjet, vendburimet minerare, burimet hidrike me potencial ujitës e hidroenergjitik, klima e mirë dhe peizazhi malor.

Kjo zonë është një nga më të pasurat me mineral kromi në Ballkan dhe shfrytëzohet prej mbi 60 vjetësh. Minierat kryesore janë Bulqiza, Krasta e Tërnavë. Gjithashtu ka ekzistuar dhe industria e pasurimit të kromit në Bulqizë. Sipas të dhënave të Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë (2014), në territorin e Bulqizës veprojnë 119 aktivitete me leje minerare aktive, nga të cilat 112 me leje shfrytëzimi, 4 me leje kërkim zbulimi dhe 3 me leje zbulimi. 111 leje minerare janë për mineralin krom dhe 7 leje për mineralin sterile kromi. Territori që mbulojnë lejet minerare është 28.6828 km² (4.2% e territorit), nga të cilat 26.0154 km² nga lejet e shfrytëzimit, 2.0014 km² nga lejet kërkim zbulimi dhe 0.666 km² nga lejet e zbulimit. Vetëm një pjesë e rentës minerare është derdhur në buxhetin e bashkisë.²¹

Për shkak të aktivitetit minierar të kërkim shfrytëzimit janë hasur disa problematika mjedisore, ku mund të përmendim shkatërrimin e tokës dhe sipërfaqjeve të gjelbra nga karrierat e kromit që gërmojnë në shtresat sipërfaqësore, nga mbetjet e kromit dhe mbeturinat inerte të hedhura në sipërfaqje etj. Këto dëmtime shkaktohen kryesisht nga subjekte që nuk respektojnë lejet mjedisore ose që nuk janë të licensuara. Gjithashtu nga intervistat me grupet e interesit është evidentuar edhe problemi i ndotjes së shtresave ujëmbajtëse nëntokësore, pasi uji i dalë nga pusët e galerive përmban grimca të ngurta, që vijnë nga lëndë plasëse si dhe nga gazrat që dalin në thellësi mbi 800 m.

Pyjet janë një pasuri shumë e madhe e Bashkisë Bulqizë. Ato fillojnë tek kurora në malin e Dhoksit dhe përfundojnë deri në kufi me Dibrën, Klosin dhe Librazhdin, duke mbuluar një sipërfaqe prej 35 020 ha, më tepër se gjysma e sipërfaqes së bashkisë. Dominojnë pyjet e ahut, dushqeve dhe te pishës. Një pjesë e tyre kanë qenë pyje komunale dhe do të kalojnë në varësi të bashkisë. Ka dhe parqe kombëtare. Sipas të dhënave të Ministrisë së Mjedisit mbi rrjetin e Zonave të Mbrojtura, në Bashkinë Bulqizë gjenden dy zona mjaft të rëndësishme nga pikëpamja mjedisore dhe turistike: zona Shebenik-Jabllanicë 167,6 ha dhe zona Mali me Gropa-Bizë- Martanesh 9036 ha.²² Për vetë sipërfaqen e madhe që zënë, pyjet vijnë pas resurseve minerare përse i përket rëndësisë ekonomike dhe mjedisore. Megjithatë, ato janë dëmtuar masivisht nga shfrytëzimi pa kriter. Prerjet pa leje dhe mosripërtëritja e sipërfaqeve të shfrytëzuara kanë shkaktuar një degradim të situatës së tyre (p.sh. masivet në Tërnovë,

²¹ Neni 40 i ligjit nr 10304, datë 15.7.2010 "Për sektorin minierar në RSH.

²² Zona të mbrojtura janë edhe Vali, Brosh-Berdhet dhe Ballenja.

Prat, Ballenjë). Në sipërfaqet e konsiderueshme të zhveshura nga pyjet, vihen re probleme të rënda të erozionit, ashpërsimit të klimës etj.

Bashkia Bulqizë është një zonë e pasur me bimë të shumta mjekësore. Ndërsa para viteve '90, në Shupenzë ka ekzistuar një qendër për grumbullimin e bimëve mjekësore, sot ajo nuk është më dhe banorët që mbledhin bimë mjekësore nuk kanë një pikë të garantuar grumbullimi. Ata përpiqen të gjejnë vetë tregun e shitjes duke hasur vështirësi në marrjen e informacionit për cilësinë e bimëve dhe parametrat e kërkuara.

Bashkia Bulqizë përshkohet nga disa arterie lumenjsh, si Zalli i Bulqizës, degë e Drinit të Zi, Zalli i Okshtunit, lumi Mat etj. Në lartësitë e maleve gjenden liqene të shumtë akullnajore, si Liqeni i Zi, Liqeni i Bardhë, Liqeni i Sopeve, Liqeni i Balgjajve etj. Mosdisiplinimi i lumenjve, rrjeti kullues i amortizuar, pjerrësia e terrenit, prerja e pakontrolluar e pyjeve dhe mungesa e investimeve për rregullimin e regjimit ujor po ndikojnë në shtimin e gërryerjeve dhe degradimin e vazhdueshëm të tokave.

Bulqiza ka potencial të mirë për zhvillimin e turizmit. Ajo gëzon kushte të përshtatshme klimatike, peizazh të bukur, sipërfaqe të madhe pyjore, prodhime bujqësore dhe blegtorale të pastra.

Tradita kulturore dhe etnografike e Bulqizës është e pasur. Këtu gjenden monumente natyrore, kulture, gjeomonumente, hidromonumente e biomonumente (shih tabelën 1).

Tabela 1 Monumentet e bashkisë Bulqizë

Monumente natyrore	Gjeomonumente	Monumente kulture
Lugina e Drinit të Zi, Malësia e Pratitis, Pllaja e Peladhit,	Shpella e Urës së Qytetit Shkëmbi i Qytetit, Xixëll Martanesh,	Teqja e Bllacës , Teqja e babë Shehut (Boçevë), Kisha e Kovashicës (rrenoja),
Mali Homeshi, hurdhata e Bllacës, Delgjurra	Shpella e Ftohtë Gjurat, Shpella e Xixëlles (Valikardhë)	Xhamia e Vleshës, Kulla e Krajkave,
Liqeni i Zi, Liqeni i Bardhë, Zabeli i madh, Zalli i Bulqizës	Hidromonumente Tri Çezmat e Zerqanit Ujëvara e Duriçit Gurra e Vakëfit të Zerqanit, Liqeni i Zi	Fusha e kalasë, Kisha e Kaziakut, maja e varrezave (Sofraçan), Gardhi i Gurrës,
Drini i Zi, Zalli i Okshtunit, mali i Ramnagores	Biomonumente Bregu i Pepesë, Qarri i Muharremit Qarri i Kovashicës, Qarri i Gjinovecit	Lapidari i krijimit të batalionit partizan, lapidari i dëshmorit të atdheut Mane Kazani, Lapidari i Tercilio Kardinalit
	Pisha Zogje, Qarri Peladhi, Zabeli i Madh Zerqan	Kulla e Markëve, Kulla e Kurteve(Shupenzë),

Për shkak të relievit, zhvillimi i turizmit lidhet kryesisht me turizmin malor. Zona vizitohet më shpesh në verë, pasi në stinët e tjera rrugët bëhen të pamundura për t'u kaluar. Aktivitetet kulturore që zhvillohen çdo vit si Festa e Mollës, Festa e Ballenjës dhe Festa e Gjoricës tërheqin vëmendjen e turistëve. Edhe qendra e Kulturës Bulqizë ka krijuar një traditë të mirë.

Këto resurse krijojnë kushte të përshtatshme për zhvillimin e turizmit rural të interesit të veçantë, turizmit të natyrës dhe agroturizmit. Ndonëse, nga ana tjetër infrastruktura rrugore tepër e amortizuar dhe relievi i thyer vështirëson aksesin, sidomos në zonat e thella malore. Monumentet kanë nevojë për përkujdesje dhe mbrojtje nga dëmtimet. Vizibiliteti i resurseve, marketingu territorial, sinjalistika turistike dhe prania e tureve të organizuara janë thuajse inekzistente dhe sporadike. Në sektorët mbështetës të turizmit, si bujqësia, blegtoria, artizanati etj. ka mungesa të theksuara organizimi, mungojnë tregjet e produkteve të freskëta dhe qendrat e prodhimit e tregtimit të produkteve artizanale. Gjithashtu, mangësi ka dhe në fushën e planifikimit, pasi nuk ekziston një strategji e mirëfilltë vendore e zhvillimit të turizmit. Mungojnë kurset e kualifikimit dhe arsimi profesional për burimet njerëzore që punojnë në sektorin e shërbimeve turistike.

4.5 Infrastruktura dhe shërbimet

Bashkia Bulqizë ka 137 km rrugë rurale dhe 68 km rrugë ndërrbane, që përfaqësojnë përkatësisht 26% dhe 25% të përqindjes totale të qarkut Dibër. Largësia nga kryeqyteti, aeroporti Nënë Tereza dhe nga pika kufitare e Bllatës me Maqedoninë nuk janë të mëdha, por rruga me karakteristika të theksuara malore, me kthesa të forta dhe vende-vende e dëmtuar bën që koha e udhëtimit të jetë e gjatë dhe aksesin i vështirë. Përsa i përket pjesës malore të bashkisë, gjatë dimrit paraqiten kushte udhëtimit mjaft të vështira për shkak të temperaturave të ulta, ngricës dhe reshjeve të dëborës.

Tabela 2 Largësitë kryesore

Largësia km	Bllatë	Aeroporti N.Tereza	Tiranë
Bulqizë	34km	114km	127km

Burimi: Strategjia e Qarkut Diber

Shqetësim përbën sidomos gjendja e rrugëve që sigurojnë akses tek objektet dhe zonat me interes turistik e rekreativ. Për të gjitha arsyet që përmendëm, infrastruktura rrugore e bashkisë kërkon vëmendje dhe investime serioze.

Ndërmarrja e ujit të pijshëm dhe e ujërave të zeza të Bulqizës furnizon me ujë banorët e 2 nga 8 NJQV-të e bashkisë (25% Bulqiza dhe Shupenza) që përbëjnë 44% të banorëve të bashkisë. Ndërmarrjet e tjera furnizojnë me ujë të pijshëm banorët e NJQV-ve të tjera. Njësia Bulqizë dhe njësia e Fushë-Bulqizës kanë një sistem pothuajse universal të furnizimit me ujë, ndërsa rreth dy të tretat e komunës së Zerqanit dhe më shumë se gjysma e Shupenzës dhe Martaneshit kanë ujë të pijshëm në banesa. Tre komunat e tjera kanë një përqindje të vogël të shtëpive që furnizohen me ujë të pijshëm.

Një problem tjetër është trajtimi i ujërave të ndotura urbane. Ato shkarkohen në lumenj ose kolektorë pa patur asnjë lloj trajtimi. Për shembull, ujërat e ndotura të Bulqizës së Re e të Vjetër mblidhen në kolektorin e fushës së Vajkalit që është në mes të dy qyteteve. Vetëm 3 njësi të bashkisë nuk kanë shërbimin e menaxhimit të mbetjeve. Nga 5 njësitë që e kanë këtë shërbim, asnjëra prej tyre nuk mbulohet plotësisht, 2 prej tyre mbulohen deri në 50% dhe 2 të tjerat kanë vetëm një mbulim prej një të tretave. Mbulimi në të gjithë bashkinë është rreth 39%. Bulqiza mbledh pjesën më të madhe të tarifave (66%) për grumbullimin e mbetjeve, krahasuar me 33% të tarifave të pastrimit që mblidhen në të gjithë qarkun. Vend-depozitimi i mbetjeve të Bulqizës, i pozicionuar buzë rrugës, është i zbuluar dhe ka një sasi të madhe mbeturinash të depozituara të cilat trajtohen me djegie. Mbeturinat depozitohen të pandara duke rritur shumë volumin e mbetjeve. Prandaj shfaqet si i domosdoshëm ndërtimi i një landfilli në mënyrë që mbetjet e kësaj zone të trajtohen në mënyrë efektive.

Bashkia Bulqizë ka më pak se 1/4 e qendrave shëndetësore në qark. Pothuajse të gjitha qendrat ndodhen në zona të largëta. Shërbimi shëndetësor ofrohet nga 8 qendra shëndetësore dhe 37 ambulanca, nga të cilat 28 janë funksionale dhe 9 jashtë funksionit për shkak të amortizimit dhe mungesës së investimeve. Këto qendra jo funksionale gjenden në qytetin Bulqizë (1), në Fushë-Bulqizë (1), në Zerqan (1), në Shupenzë (1), në Gjoricë (2) dhe në Ostren (3).

Bashkia Bulqizë ka 34 kopshte, 20 shkolla fillore dhe 5 shkolla të mesme, 88% e të cilave ndodhen në zonat rurale. Ndërkohë, 67% e fëmijëve të bashkisë banojnë në zonat rurale, ku japin mësim 72% e mësuesve. Zonat rurale në Bulqizë kanë më shumë shkolla dhe mësues për fëmijë sesa zonat urbane. Në fshatrat e zonave të thella, nxënësit detyrohen të përshkojnë rrugë të gjata për të frekuentuar shkollat më të afërta. Një pjesë e tyre e bëjnë rrugën me këmbë ose me mjete të rastit, gjë që në kushtet e dimrit të ashpër dhe motit të keq vë në rrezik jetën dhe shëndetin e tyre. Në lidhje me infrastrukturën arsimore vihet re në mjaft raste se ajo është e vjetër. Po kështu mungojnë ambientet sportive, si palestra e fusha sporti. Megjithëse bëhen përpjekje për rritjen e nivelit arsimor e kulturor të të rinjve, mungojnë mjediset e bibliotekave pranë shkollave.

Komuniteti i Bulqizës është mjaft sportdashës, por edukimi nëpërmjet sportit has vështirësi sepse infrastrukturës sportive të bashkisë i mungojnë ambientet, si p.sh. stadiumi ose fushat e sportive. Qendra kulturore Bulqizë është aktive, por ka nevojë për ripërtëritje të mjeteve dhe mjediseve. Qyteti ka fasada të dëmtuara, mungojnë sipërfaqet e gjelbra dhe ambientet rekreative për fëmijët dhe të rinjtë. Shfaqet qartë nevoja për rikualifikim urban. Ndërkohë, nga intervistat me grupet e interesit u evidentua mungesa e shërbimit urban për lidhjen e dy pjesëve të qytetit Bulqizë.

Nga ana e drejtuesve të bashkisë ekziston vullneti i mirë për të modernizuar shërbimet dhe mjediset në dobi të një shërbimi sa më cilësor ndaj individit dhe publikut të gjerë.

4.6 Konkluzionet

Bashkia Bulqizë karakterizohet një popullsi kryesisht rurale, relativisht e re dhe me një shkallë mjaft të lartë shpopullimi. Norma e individëve me arsim të mesëm dhe të lartë është më e ulët se norma në rang qarku dhe vendi.

Aktivitetet ekonomike që ushtrohen në territorin e bashkisë janë bujqësia, blegtoria, industria minerare, shfrytëzimi i pyjeve, grumbullimi i bimëve mjekësore, shërbimet etj. Territori karakterizohet nga peizazh i bukur, mjedisi malor dhe resurse të pasura kulturore e natyrore, që përbëjnë potenciale për zhvillimin e turizmit.

Bujqësia është e organizuar në ferma të vogla familjare, sipërfaqja e tokës së punueshme është e vogël, e copëzuar dhe shumë prej saj e pandarë. Rreth 34.5% e të punësuarve janë të angazhuar **në sektorin e bujqësisë**. Sistemi i ujitjes është i amortizuar. Mungon infrastruktura e grumbullimit, paketimit dhe përpunimit të produkteve bujqësore. Skema e menaxhimit dhe mirëmbajtjes së infrastrukturës së ujitjes vlerësohet si e papërshtashme. Tek fermerët mbisundon mentaliteti individual dhe mungojnë qasjet e punës në grup.

Aktualisht, industria minerare nuk kontribuon sa duhet në ekonominë e zonës për shkak të mosderdhjes së rentës minerare.

Vjelja e taksave dhe detyrimeve nga ana e bashkisë është në nivel të ulët për shkak të pamundësisë financiare të njëjësive familjare. Numri i bizneseve për banor është i vogël dhe mungojnë skemat mbështetëse.

Mbarështimi i blegtorisë është një aktivitet më rëndësi në zonë, por nuk ekzistojnë të gjitha hallkat e zinxhirit të prodhimit. Mungesa e baxhove, infrastruktura e papërshtashme, promovimi i dobët, mungesa e markës dhe emigrimi i krahut të punës shihen si shqetësuese nga blegtorët e zonës.

Niveli i zhvillimit social dhe i burimeve njerëzore nuk është shumë i lartë. Papunësia, varfëria dhe përjashtimi social janë fenomene shqetësuese. Arsimimi dhe punësimi i banorëve dhe veçanërisht i grave qëndron në nivele të ulëta për shkak të mendësisë patriarkale dhe veçorive të zhvillimit ekonomik të zonës, i orientuar më së shumti nga industria e rëndë, pylltaria, hidrocentralet etj. Nevoja për ngritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore, nëpërmjet arsimit profesional, trajnimeve në fushën e menaxhimit të projekteve, integritimit evropian etj. është një domosdoshmëri.

Pjesëmarrja e balancuar e burrave dhe grave në vendimarrje është shumë larg kërkesave të ligjit.

Mbështetja e ekonomisë kryesisht tek minierat dhe kufizimi i mundësive të punësimit, kërkojnë diversifikim të ekonomisë së bashkisë edhe në sektorë të tjerë, si në shërbime, turizëm, agrobiznes, artizanat etj.

Infrastruktura arsimore, sociale, kulturore, sportive e shëndetësore është e vjetër dhe kërkon

përmirësime. Nevojat për një transport publik në qytet dhe për transportin e nxënësve në zonat e largëta rurale janë evidente.

Turizmi është thujtë inekzistent si aktivitet për shkak të mungesave të organizimit të zinxhirit të vlerës, infrastrukturës së keqe rrugore e turistike, mungesës së vizibilitetit dhe marketingut territorial.

Ka probleme të rënda mjedisore për shkak të shfrytëzimit jo të qëndrueshëm e të paplanifikuar të resurseve natyrore minerare, pyjore, ujore etj. Shpyllëzimi pa kriter është një problem i mprehtë që dëmton jo vetëm mjedisin, por edhe perspektivën afatgjatë të zhvillimit të bashkisë. Në kuadër të moratoriumit për ndalimin e prerjes së pyjeve që do të hyjë në fuqi, problemi i shpyllëzimit duket se do të marrë zgjidhje.

Ka një angazhim të fortë të drejtuesve vendorë për një zhvillim të diversifikuar dhe të qëndrueshëm ekonomik, social dhe mjedisor. Planifikimi vendor ekziston në nivel njësie administrative, ndërsa shihet si domosdoshmëri planifikimi në nivel bashkiak duke theksuar procesin me pjesëmarrje.

Agjencitë e zhvillimit vendor apo praktikat e zhvillimit vendor të udhëhequr nga komuniteti, siç janë grupet lokale të veprimit (LAG) nuk ekzistojnë.

Bashkia mund të përfitojë fonde për projekte zhvillimi nga fondi i rajoneve, fondet e turizmit dhe të bashkëpunimit ndërkufitar.

Duke krahasuar në mënyrë të përmbledhur problematikën në Bashkinë Bulqizë me prioritetet e programit të Kryetarit të Bashkisë, Melaim Damzi vëmë re se përfundime të përbashkëta janë arritur për:


- nevojën për rritjen e të ardhurave që bashkia përfiton nga shfrytëzimi i burimeve natyrore si miniera, pyje, energji hidrike dhe të ardhura nga tatim-taksat;
- shfrytëzimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore, veçanërisht të pyjeve;
- nxitjen e zhvillimit të bujqësisë e blegtorisë dhe zinxhirit të vlerës së tyre në funksion të punësimit dhe zhvillimit të turizmit;
- përmirësimin e infrastrukturës bazë të Bashkisë Bulqizë në funksion të rritjes së cilësisë së jetesës;
- fuqizimin ekonomik e social të shtresave vulnerabël, veçanërisht të grave nëpërmjet krijimit të shanseve të barabarta në punësim, arsim, shërbime e vendimmarrje;
- përpjekje më të mëdha në përmirësimin e burimeve njerëzore të Bashkisë Bulqizë dhe qëverisjes së mirë, në kuadër edhe të integritimit në BE;
- nevojën për planifikim të integruar të zhvillimit në Bashkinë Bulqizë;
- nevojën për investime në kulturë, art dhe aktivitete rekreative;
- krijimin e strukturave të nxitjes së zhvillimit vendor me fokus edhe përfitimin e fondeve nga programet e BE-së.

5.


Përcaktimi i problemeve dhe prioriteteve afat-shkurtra operacionale

Për analizën e problemeve u përdor metoda “Analiza në trajtë peme e problemit” që përfshin përcaktimin e problemeve kryesore dhe krijimin e lidhjeve shkak-pasojë-problem-efekt. Qëllimi kryesor i analizës ishte identifikimi dhe adresimi i vazhdueshëm i shkaqeve bazë (dhe jo i simptomave të problemit).

Në vijim pema e analizës së problemit:



Duke analizuar hierarkinë e problemeve, në konsultim të ngushtë dhe me pjesëmarrjen e grupeve të interesit të përfshirë në procesin e planifikimit operacional, analiza e thelluar shkak-pasojë qartëson panoramën e çështjeve më problematike që pengojnë zhvillimin e Bashkisë Bulqizë dhe shfrytëzimin eficient të potencialeve të saj njerëzore e natyrore, duke mbërritur më pas në formulimin e objektivave për ndryshimin e gjendjes.



PRIORITETI 1: Përfshirje e aktivizim i potencialeve të shtresave vulnerabël në shoqëri nëpërmjet krijimit të shanseve të barabarta për punësim, arsimim e trajnim si edhe përfshirjes në strukturat e vendimmarrjes.

■ **Masa 1** Nxitja e punësimit të të rinjve dhe sidomos grave nëpërmjet politikave që synojnë diversifikimin e ekonomisë lokale dhe hapjen e vendeve të reja të punës.

■ **Masa 2** Nxitja e hapjes së institucioneve të arsimit profesional publik e privat dhe kurseve të kualifikimit.

■ **Masa 3** Monitorimi i zbatimit të kuotave gjinore në strukturat vendimmarrëse dhe inkurajim i shtimit të numrit të grave në to.

■ **Masa 4** Nxitja e përmirësimit të pozitës së gruas dhe ndryshimit të mendësisë patriarkale nëpërmjet inkurajimit të shoqatave që promovojnë fuqizimin e gruas dhe rritjen e rolit të saj në shoqëri.

PRIORITETI 2: Shfrytëzim i plotë i potencialeve në bujqësi e blegtori nëpërmjet krijimit të infrastrukturës mbështetëse moderne dhe nxitjes së ekonomisë së shkallës.

■ **Masa 1** Rikonstruksioni i sistemeve ujitëse e kulluese.

■ **Masa 2** Ndërtimi i tregjeve dhe pikave moderne të magazinimit dhe përpunimit të produkteve bujqësore e blegtorale.

■ **Masa 3** Ndërmarrja e nismave për eliminimin e copëzimit të fermave dhe krijimin e ekonomisë së shkallës.

■ **Masa 4** Stimulimi nga ana e pushtetit vendor i mekanizmave financiare për subvencionimin e inputeve dhe investimeve.

PRIORITETI 3: Zhvillimi i zinxhirit të vlerës së turizmit dhe shndërrimi i tij në burim punësimi dhe mirëqenie në Bashkinë Bulqizë.

■ **Masa 1** Mbrojtja dhe përmirësim i mjedisit dhe sidomos i masiveve pyjore, parqeve e zonave të mbrojtura.

■ **Masa 2** Përmirësimi i infrastrukturës turistike informuese.

■ **Masa 3** Përmirësimi i marketingut territorial për Bashkinë Bulqizë.

■ **Masa 4** Rritja e vizibilitetit të resurseve turistike.

■ **Masa 5** Kualifikim i burimeve njerëzore në fushën e menaxhimit të turizmit.

■ **Masa 6** Promovimi i traditave më të mira të artizanatit vendas dhe zhvillimi i tij në funksion të turizmit.

■ **Masa 7** Përmirësimi i subvencionimit për aktivitetet start up në fushën e turizmit.

■ **Masa 8** Planifikim strategjik i zhvillimit të turizmit në Bashkinë Bulqizë.

■ **Masa 9** Gjallërimi i jetës kulturore, artistike e sportive dhe infrastrukturës përkatëse.

PRIORITETI 4: Investimi në burime njerëzore të kualifikuara për përballimin e

sfidave të konkurrencës globale.

- **Masa 1** Investim në ngritje të kapaciteteve të administratës publike për shërbime cilësore ndaj publikut dhe në kuadër të integritit europian.

- **Masa 2** Nxitja e frekuentimit të arsimit profesional dhe kurseve të kualifikimit.

PRIORITETI 5: Menaxhim i qendrueshëm i burimeve natyrore dhe mjedisit nëpërmjet planifikimit të integruar urban dhe rural të territorit, mbrojtjes së pasurive natyrore dhe rritjes së përfitimeve që vijnë nga ato.

- **Masa 1** Planifikim i zhvillimit urban e rural në Bashkinë Bulqizë dhe krijimi i Agjencisë së Zhvillimit Vendor dhe Grupeve të Veprimit Lokal (LAG).

- **Masa 2** Mbrojtja dhe përmirësimi i mjedisit nga dëmtimet dhe prej shfrytëzimit pa kriter të burimeve natyrore.

- **Masa 3** Sigurimi i përfitimeve më të mëdha për komunitetin vendor nga dhënia për shfrytëzim e pasurive natyrore, pyjeve, minierave, hidrocentraleve.

PRIORITETI 6: Kthimi në gjendje normale të infrastrukturës bazë në dobi të një jetese cilësore në Bashkinë e Bulqizës.

- **Masa 1** Ndërhyrje në përmirësimin e infrastrukturës rrugore, furnizimit me ujë e kanalizimeve.

- **Masa 2** Ndërhyrje në përmirësimin e infrastrukturës shëndetësore, sociale e arsimore.

- **Masa 3** Sigurimi i një menaxhimi të qendrueshëm të mbetjeve.

FORMULIMI I SYNIMEVE STRATEGJIKE

Synimi 1 Bashkia Bulqizë do të karakterizohet nga një zhvillim ekonomik i diversifikuar dhe i qendrueshëm, i bazuar tek shfrytëzimi me plan i pasurive të saj të mëdha natyrore, duke synuar rritjen e mirëqenies dhe cilësisë së jetesës për të gjithë banorët e saj dhe duke konkurruar me sukses në nivel kombëtar e rajonal.

Synimi 2 Bashkia Bulqizë do të rrisë përfshirjen dhe fuqizimin social dhe ekonomik të grave dhe shtresave të tjera vulnerabël me synim rritjen e barazisë sociale dhe kohezionit social e ekonomik.

Vizioni

Bulqiza, komunitet në mirëqenie e prosperitet të vazhdueshëm, e pastër, e gjelbër dhe me akses të përmirësuar në shërbimet bazë për të gjithë. Një ndërthurje e vlerave historike dhe kulturore me resurset natyrore dhe turistike për një zhvillim të qendrueshëm ekonomik, social dhe mjedisor të udhëhequr nga komuniteti.

6.

Plani operacional

Bulqiza, komunitet në mirëqënie e prosperitet të vazhdueshëm, e pastër, e gjelbër dhe me akses të përmirësuar në shërbimet bazë për të gjithë. Një ndërthurje e vlerave historike dhe kulturore me resurset natyrore dhe turistike për një zhvillim të qendrueshëm ekonomik, social dhe mjedisor të udhëhequr nga komuniteti.

Prioriteti operacional	Projekti konkret	Grupi i synuar / Target grupi	Periudha e zbatimit	Kosto e përafërt në mijëra/lekë	Përgjegjës dhe zbatues	Burimet financiare në %	Metoda e zbatimit	Impakti i pritshëm
Përmirësimi i infrastrukturës rrugore dhe volumit të transportit	Rikonstruksioni i rrugës së fshatit Dushaj	590 banorë	2016	55440	Bashkia	Bashkia Rajoneve	Metoda e investimeve publike	Përmirësimi i shërbimit të transportit dhe rritja e aksesit në shërbimet bazë
	Sistemi i Asfaltim Rruga Biloku i Poshtem, Lagja Minatori	5000 banorë	2016	31 457	Bashkia	Bashkia Rajoneve	Metoda e investimeve publike	Përmirësimi i shërbimit të transportit dhe rritja e aksesit në shërbimet bazë
	Sistemi i Asfaltim Rruga përballë Spitalit, Lagja Minatori	5000 banorë	2016	31 457	Bashkia	Bashkia Rajoneve	Metoda e investimeve publike	Përmirësimi i shërbimit të transportit dhe rritja e aksesit në shërbimet bazë
	Sistemi i asfaltimi i rrugës Ura e Serbinit-Shtushaj	8000 banorë	2016	224988	Bashkia	Bashkia Rajoneve	Metoda e investimeve publike	Përmirësimi i shërbimit të transportit dhe rritja e aksesit në shërbimet bazë
	Rikonstruksioni i Unazës së Sipërme, Bashkia Bulqizë	10 000 banorë të bashkisë	2016	70029	Bashkia	Bashkia Rajoneve	Metoda e investimeve publike	Përmirësimi i cilësisë së jetës, mbrojtja e mjedisit, sistemim i kanalizimeve të ujërave të bardha e të zeza
	Ndërtimi i urës tre çezmat, Zerqan	1200 banorë	2016	29892	Bashkia	Bashkia Rajoneve	Metoda e investimeve publike	Përmirësimi i shërbimit të transportit dhe rritja e aksesit në shërbimet bazë
	Rikonstruksioni i rrugës së fshatit Fushë-Bulqizë	2500 banorë	2017	17920	Bashkia	Bashkia Rajoneve	Metoda e investimeve publike	Përmirësimi i shërbimit të transportit dhe rritja e aksesit në shërbimet bazë
	Sistemi i asfaltimi i rrugës së lagjes Dane-Fushë e Thatë, Gjoricë	Banorët e lagjes Dane	2017	61681	Bashkia	Bashkia Rajoneve	Metoda e investimeve publike	Përmirësimi i shërbimit të transportit dhe rritja e aksesit në shërbimet bazë
	Ndërtimi i rrugës Gacet Qarr-Qafa e Dardhave- Stavec- Ura e Blishes	1000 banorë	2017	26602	Bashkia	Bashkia Rajoneve	Metoda e investimeve publike	Përmirësimi i shërbimit të transportit dhe rritja e aksesit në shërbimet bazë
	Sistemi i asfaltimi i rrugës Spitalit Shupenzë	4500 banorë	2017	4764	Bashkia	Bashkia Rajoneve	Metoda e investimeve publike	Përmirësimi i infrastrukturës rrugore dhe transportit
	Sistemi i asfaltimi i Unazës së lagjes Cenga, Homezh	200 banorë	2017	25012	Bashkia	Bashkia Rajoneve	Metoda e investimeve publike	Përmirësimi i shërbimit të transportit dhe rritja e aksesit në shërbimet bazë
	Sistemi i asfaltimi i rrugës lagja Ciflig, Gjorice	Banorët e lagjes Ciflig	2017	51355	Bashkia	Bashkia Rajoneve	Metoda e investimeve publike	Përmirësimi i shërbimit të transportit dhe rritja e aksesit në shërbimet bazë

Sistemit asfaltimi i rrugës së fshatit Peladhi e Sipërme	150 banorë	2017	12836	Bashkia	Bashkia Fondi i Rajoneve	Metoda e investimeve publike	Përmirësimi i shërbimit të transportit dhe rritja e aksesit në shërbimet bazë
Sistemit asfaltimi i rrugës së fshatit Peladhi e Poshtme	700 banorë	2017	23327	Bashkia	Bashkia Fondi i Rajoneve	Metoda e investimeve publike	Përmirësimi i shërbimit të transportit dhe rritja e aksesit në shërbimet bazë
Sistemit asfaltimi i rrugës Zall Sopot, Sirkëcan	1500 banorë	2017	58800	Bashkia	Bashkia Fondi i Rajoneve	Metoda e investimeve publike	Përmirësimi i shërbimit të transportit dhe rritja e aksesit në shërbimet bazë
Ndërtimi i rrugëve automobilistike për në pikat turistike të Dhoksit dhe Liqenit të Zi	Turistët	2017	10000	Bashkia	Bashkia Fondi i Rajoneve Min transportit	Metoda e investimeve publike	Shfrytëzim i resurseve turistike
Rikonstruksioni i rrugës kryqezim i tre fshatrave Kocaj	1000 banorë	2018	21700	Bashkia	Bashkia Fondi i Rajoneve	Metoda e investimeve publike	Përmirësimi i shërbimit të transportit dhe rritja e aksesit në shërbimet bazë
Sistemit asfaltimi i rrugës lagja Zall - Kaje ,Fshati Gjorice	Banorët e lagjes Zall - Kaje	2018	65305	Bashkia	Bashkia Fondi i Rajoneve	Metoda e investimeve publike	Përmirësimi i shërbimit të transportit dhe rritja e aksesit në shërbimet bazë
Sistemit asfaltimi i rrugës Fshatit Okshatine -lagja Xheleke	230 banorë	2018	12090	Bashkia	Bashkia Fondi i Rajoneve	Metoda e investimeve publike	Përmirësimi i shërbimit të transportit dhe rritja e aksesit në shërbimet bazë
Sistemit asfaltimi i rrugës nga shkolli CU - lagja Manjant e Sipërme-Fshati Homezh	750 banorë	2018	34556	Bashkia	Bashkia Fondi i Rajoneve	Metoda e investimeve publike	Përmirësimi i shërbimit të transportit dhe rritja e aksesit në shërbimet bazë
Sistemit asfaltimi i rrugës së fshatit Sopot	1000 banorë	2018	63000	Bashkia	Bashkia Fondi i Rajoneve	Metoda e investimeve publike	Përmirësimi i shërbimit të transportit dhe rritja e aksesit në shërbimet bazë
Sistemit asfaltimi i rrugës lagja Jella, Gjoricë	Banorët e lagjes Jella	2019	21213	Bashkia	Bashkia Fondi i Rajoneve	Metoda e investimeve publike	Përmirësimi i shërbimit të transportit dhe rritja e aksesit në shërbimet bazë
Sistemit asfaltimi i rrugës lagja Majmej, Gjoricë	Banorët e lagjes Majmej,	2019	22025	Bashkia	Bashkia Fondi i Rajoneve	Metoda e investimeve publike	Përmirësimi i shërbimit të transportit dhe rritja e aksesit në shërbimet bazë
Sistemit asfaltimi i rrugës Vija e Lazre -Burimi i Gurrës së Leka, Homezh	1000 banorë	2019	58233	Bashkia	Bashkia Fondi i Rajoneve	Metoda e investimeve publike	Përmirësimi i shërbimit të transportit dhe rritja e aksesit në shërbimet bazë

Krijimi i nje infrastrukture arsimore shkollore e parashkollore bashkekohore																			
Sistemim asfaltim i rrugës së fshatit Sofracan	700 banorë	2019	12489	Bashkia	Bashkia	Fondi i Rajoneve	Metoda e investimeve publike	Përmirësimi i shërbimit të transportit dhe rritja e aksesit në shërbimet bazë											
Sistemim asfaltim i rrugës së fshatit Krajke	800 banorë	2019	28 211	Bashkia	Bashkia	Fondi i Rajoneve	Metoda e investimeve publike	Përmirësimi i shërbimit të transportit dhe rritja e aksesit në shërbimet bazë											
Rikonstruksioni i shkollës së mesme Shupenzë	400 nxënës dhe 21 mësues	2016	22500	Bashkia	Bashkia	Min Arsimit	Metoda e investimeve publike	Përmirësimi i kushteve të arsimit											
Rikonstruksioni i kopshtit Nr. 1 Lagja Minatori, Bashkia Bulqizë	60 fëmijë	2016	21 002	Bashkia	Bashkia	Min Arsimit	Metoda e investimeve publike	Përmirësimi i kushteve të arsimit											
Rikonstruksioni i shkollës 9-Vjeçare Sopot	150 nxënës	2016	9535	Bashkia	Bashkia	Min Arsimit	Metoda e investimeve publike	Përmirësimi i kushteve të arsimit											
Rikonstruksioni i Sshkollës I. Daci Shupenze	420 nxënës dhe 26 mësues	2016	10500	Bashkia	Bashkia	Min Arsimit	Metoda e investimeve publike	Përmirësimi i kushteve të arsimit											
Rikonstruksioni i shkollës Cikli i ulët Fushe-Bulqizë	50 nxënës	2017	8353	Bashkia	Bashkia	Min Arsimit	Metoda e investimeve publike	Përmirësimi i kushteve të arsimit											
Rikonstruksioni i shkollës 9-Vjeçare Strikcan	150 nxënës	2017	12417	Bashkia	Bashkia	Min Arsimit	Metoda e investimeve publike	Përmirësimi i kushteve të arsimit											
Rikonstruksioni i shkollës së Mesme Zerqan	200 nxënës	2017	13756	Bashkia	Bashkia	Min Arsimit	Metoda e investimeve publike	Përmirësimi i kushteve të arsimit											
Ndërtimi i palestërës sëshkollës sëmesme Zerqan	200 nxënës	2018	17584	Bashkia	Bashkia	Min Arsimit	Metoda e investimeve publike	Përmirësimi i mësimdhënies së fiskulturës. Rritja e aktiviteteve argëtuese.											
Rikonstruksioni i shkollës 9-vjeçare Godvi	200 nxënës	2018	4857	Bashkia	Bashkia	Min Arsimit	Metoda e investimeve publike	Përmirësimi i mësimdhënies së fiskulturës. Rritja e aktiviteteve argëtuese.											
Rikonstruksioni i çerdheve 1 dhe 2 Bulqizë	Fëmijët	2016	4500	Bashkia	Bashkia	Fondi i Rajoneve	Metoda e investimeve publike	Përmirësimi i kushteve të jetesës së fëmijëve											

Rikonstruksion i rrjetit ujtes e kullues	Ndërtim shtese i shkollës "Shaban Elmazi" Ostren i Vogël	105 nxënës dhe 8 mësues	2017	8000	Bashkia	Bashkia Fondi i Rajoneve Min Arsimit	Metoda e investimeve publike	Përmirësimi i kushteve të arsimimit
	Ndërtimi i shkollës CU Vajkal Bulqizë	40 nxënës 2 mësues dhe 1 edukatore	2019	15000	Bashkia	Bashkia Fondi i Rajoneve Min Arsimit	Metoda e investimeve publike	Përmirësimi i kushteve të arsimimit
	Rehabilitimi i kanalit vaditës Tucep - Cereneç	350 Fermer të 8 fshatrave	2016	84000	Bashkia		Metoda e investimeve publike	Rritja e sipërfaqeve të vaditura. Rritja e rendimeteve bujqësore dhe të ardhurave
	Ndërtimi i kanalit ujitës Zaall i Bulqizës deri Fushë-Bulqizë Faza II	1500 banorë	2017	13362	Bashkia	Bashkia Fondi i Rajoneve Min Bujqësisë	Metoda e investimeve publike	Rritja e sipërfaqeve të vaditura me 150 ha. Rritja e rendimeteve bujqësore dhe të ardhurave
	Ndërtimi i kanalit vaditës i fshatit Valikardhe	1500 banorë	2017	22757	Bashkia	Bashkia Fondi i Rajoneve Min Bujqësisë	Metoda e investimeve publike	Rritja e sipërfaqeve të vaditura. Rritja e rendimeteve bujqësore dhe të ardhurave
	Ndërtimi i kanalit ujitës të fshatit Kodër-Dani	300 banorë		13362	Bashkia	Bashkia Fondi i Rajoneve Min Bujqësisë	Metoda e investimeve publike	Rritja e sipërfaqeve të vaditura me 150 ha. Rritja e rendimeteve bujqësore dhe të ardhurave
	Ndërtim i ujësjetllësit Peladhi, Zerqan	500 banorë	2016	68958	Bashkia	Bashkia Fondi i Rajoneve FSHZH	Metoda e investimeve publike	Përmirësimi i furnizimit me ujë dhe i cilësisë së jetës
	Furnizimi me ujë të pijshëm i disa fshatrave - Rrjet Shpërndarës, Homezh, Boceve, Shupenzë	3400 banorët të Homeshit, Boceve dhe Shupenzës	2016	93369	Bashkia	Bashkia Fondi i Rajoneve FSHZH	Metoda e investimeve publike	Përmirësimi i furnizimit me ujë dhe i cilësisë së jetës
	Ndërtimi i kanalizimeve të ujërave të zeza në fshatin Okshatine	3500 banorë	2017	45,91	Bashkia	Bashkia Fondi i Rajoneve FSHZH	Metoda e investimeve publike	Largimi i ujërave të zeza dhe mbrojtja e shëndetit
	Rehabilitimi i ujësjetllësit fshati Kodër Dani - Dushaj	650 banorë	2018	12338	Bashkia	Bashkia Fondi i Rajoneve FSHZH	Metoda e investimeve publike	Përmirësimi i furnizimit me ujë dhe i cilësisë së jetës
Rikonstruksion i rrjetit te ujësjetllësit kanalizimeve	Ndërtim i ujësjetllësit Sofraçan	400 banorë	2018	4988	Bashkia	Bashkia Fondi i Rajoneve FSHZH	Metoda e investimeve publike	Përmirësimi i furnizimit me ujë dhe i cilësisë së jetës

Ruatja dhe mbrojtja e mjedisit ne funksion te nje jetese me cilesore dhe nxitjes se turizmit										
Ndërtimi i një kulle vrojtimi per pyjet	Banorët e Qytetit Bulqize me 11553	2016	25200	Bashkia	Bashkia Ministria e Mjedisit Donatorë	Metoda e investimeve publike	Ruatja e pyjeve			
Ndërtimi i argjaturës në lumin Drini i Zi, Gjorice	150 fermer	2016	42000	Bashkia	Bashkia Ministria e Mjedisit Donatorë	Metoda e investimeve publike	Mbrojtje nga përmblytjet e 150 familjeve dhe 156 ha tokë bujq			
Ndërtimi i një landfilli për përpunimin e mbejtjeve të qytetit Bulqizë	Banorët e Bulqizës	2016	50400	Bashkia	Bashkia Fondi i Rajoneve Donatorë	Metoda e investimeve publike	Përmirësimi i mjedisit			
Projekt pilot për ndarjen në burim të mbejtjeve urbane qyteti Bulqizë	Banorët e qytetit të Bulqizës	2017	8400	Bashkia	Bashkia Donatorë	Metoda e investimeve publike	Përmirësimi i mjedisit			
Rehabilitimi i kurorës së gjelbërt të qytetit Bulqizë	Banorët e qytetit të Bulqizës	2017	28000	Bashkia	Bashkia Ministria e Mjedisit Donatorë	Metoda e investimeve publike	Përmirësimi i mjedisit			
Ndërtimi i kampit në zonën e mbrojtur Ballenje	Banorët e Ballenjës	2017	28000	Bashkia	Bashkia Ministria e Mjedisit Donatorë	Metoda e investimeve publike	Përmirësimi i mjedisit dhe turizmit			
Rehabilitimi i Përroit të Zenge, Gjoricë	45 familje	2018	2100	Bashkia	Bashkia Ministria e Mjedisit Donatorë	Metoda e investimeve publike	Mbrojtja e 45 familjeve nga përmblytjet			
Rehabilitimi i mbejtjeve të ngurta minerale në qytetin e vjetër Bulqizë	Banorët e Qytetit të Vjetër, Bulqizë	2018	25200	Bashkia	Bashkia Ministria e Mjedisit Donatorë	Metoda e investimeve publike	Përmirësimi i mjedisit			
Ndërtimi i një liqeni artificial në kënetën Bulqizë	Banorët e Bulqizës	2019	500000	Bashkia	Bashkia Donatorë	Metoda e investimeve publike ose e specifikuar nga donatori	Përmirësimi i mjedisit dhe turizmit			
Ndërtimi i impiantit të trajtimit të ujërave të zeza, qyteti i vjetër Bulqizë	Banorët e Qytetit të Vjetër, Bulqizë	2019	40600	Bashkia	Bashkia Fondi i Rajoneve Donatorë	Metoda e investimeve publike	Përmirësimi i mjedisit			

Infrastruktura shëndetësore cilësore dhe prane qytetareve	Ndërtim i qendrës shëndetësore në Zërqaq dhe Trebisht	Banorët e Zërqaqit 5137 individë dhe të Trebishtit 1750	2016	17584	Bashkia	Bashkia Fondi i Rajoneve	Metoda e investimeve publike	Përmirësimi i shërbimit shëndetësor
	Rikonstruksioni dhe shtesë projekti me "Çati" për të gjithë ambulancat e ndërtuara (tip A-1 dhe A-2) me soletë betoni	Banorët e zonës 11533 individë	2016	20824	Bashkia	Bashkia Fondi i Rajoneve	Metoda e investimeve publike	Përmirësimi i shërbimit shëndetësor
	Rikonstruksioni i pavioneve të spitalit dhe kompletimi i sallës së operacionit Bulqizë	Banorët e zonës 11553 individë	2016	5000	Spitali	Ministria e Shëndetësisë Donatorë	Metoda e investimeve publike	Përmirësimi i shërbimit shëndetësor
	Rikonstruksioni dhe riparime në 9 objekte të qendrave shëndetësore(Ambulanca)	37 378 banorë	2017	4500	Bashkia	Bashkia Fondi i Rajoneve	Metoda e investimeve publike	Përmirësimi i shërbimit shëndetësor
	Ndërtimi i 14 ambulancave në fshatrat ku mungojnë	6960 banorë në Shupenzë	2018	14000	Bashkia	Bashkia Fondi i Rajoneve	Metoda e investimeve publike	Përmirësimi i shërbimit shëndetësor
	Ndërtimi i tregut bujqësor dhe blegtorit të Bulqizës dhe Shupenzës	Tregtarët e pakicës	2016	20000	Bashkia	Bashkia Donatorë	Metoda e investimeve publike	Përmirësimi i shërbimit dhe rritja e të ardhurave të bashkisë
	Ndërtimi i një thertorje sipas standarteve bashkëkohore	Banorët e qytetit të Bulqizës	2016	12350	Bashkia	Bashkia Biznesi	Metoda e investimeve publike	Përmirësimi i shërbimit dhe rritja e sigurisë ushqimore
	Ndërtimi i një magazine për bimët mjekësore në Shupenzë	Banorët që merren me bimët mjekësore	2017	5000	Bashkia	Bashkia Biznesi	Metoda e P-P-P	Rritja e të ardhurave për banorët
	Ndërtimi i një fabrike të përpunimit të qumështit dhe nënprodukteve të tij në Bulqizë ose Shupenzë.	Blegtorët	2017	30000	Bashkia	Bashkia Biznesi	Metoda e P-P-P	Krijimi i zinxhirit të vlerës dhe rritja e të ardhurave
	Rikonstruksioni i Fasadae, Bulevardi Lagja e Vjetër, Bashkia Bulqizë	15 000 banorë	2016	81173	Bashkia	Bashkia Fondi i Rajoneve	Metoda e investimeve publike	Përmirësimi i cilësisë së jetës. Përmirësimi i infrastrukturës
Rikualifikim urban i qendrave të banimit ne doli te rrites se cilesise se jeteses	Ndërtimi i lulishteve në lagjet "Minatori", "Gjeologu", Lagja e "Re" të qytetit Bulqizë.	Të moshuarit dhe të rinjtë	2016	10000	Bashkia	Bashkia	Metoda e investimeve publike	Përmirësimi i mjedisit dhe krijimi i kushteve për argëtim
	Ndërtimi i njëparku multifunksional për fëmijë në qytetin e Bulqizës	Fëmijët e Bulqizës	2018	6535	Bashkia	Bashkia Donatorë	Metoda e investimeve publike	Përmirësimi i cilësisë së jetës së fëmijëve

Qeverisjes e mire nepermetet per miresimet te sherbimeve ndaj qytetareve	Qeverisjes e mire nepermetet per miresimet te sherbimeve ndaj qytetareve	Ndërtimi i fushës së futbollit Bulqizë	Të rinjtë	2016	9544	Bashkia	Bashkia Donatorë Biznesi FSHF	Metoda e investimeve publike	Rritja e aktiviteve dhe përmirësimi i jetës sportive
	Qeverisjes e mire nepermetet per miresimet te sherbimeve ndaj qytetareve	Rehabilitimi i dhomës së muzikës në Qendrën Kulturore Bulqizë me paisjet e nevojshme	Grupi i muzikantëve të rinj	2016	1500	Bashkia	Bashkia Biznesi	Metoda e investimeve publike	Përmirësimi i aktiviteve kulturore
	Qeverisjes e mire nepermetet per miresimet te sherbimeve ndaj qytetareve	Krijimi i bibliotekave (sallave të studimit) në shkollat e mesme të bashkisë së re.	1184 nxënësit	2017	1150	Bashkia	Bashkia Ministria e arsimit	Metoda e investimeve publike	Rritja e mësimxënies
Diversifikimi i punesimit dhe përmirësimi i përfshirjes sociale te shtresave vulnerabel	Diversifikimi i punesimit dhe përmirësimi i përfshirjes sociale te shtresave vulnerabel	Ndërtimi i Qendrës Kulturore Zerqan	5000 banorë	2019	15754	Bashkia	Bashkia Donatorë	Metoda e investimeve publike	Rritja e aktiviteve kulturore e artistike. Ruajtja dhe promovimi i vlerave dhe traditave të zonës.
	Diversifikimi i punesimit dhe përmirësimi i përfshirjes sociale te shtresave vulnerabel	Ndërtimi i një banese sociale në Bashkinë Bulqizë	Te pastrehët	2016	60000	Bashkia	Bashkia Donatorë	Metoda e investimeve publike	Strehimi i individëve pa banesa dhe me probleme sociale
	Diversifikimi i punesimit dhe përmirësimi i përfshirjes sociale te shtresave vulnerabel	Ndërtimi i infrastrukturës në mjediset publike për levizjen e personave me aftësi të kufizuara në qytetin Bulqizë	Personat me aftësi të kufizuara	2016	4350	Bashkia	Bashkia Biznesi	Metoda e investimeve publike	Përmirësimi i cilësisë së jetës së personave me aftësi të kufizuara
	Diversifikimi i punesimit dhe përmirësimi i përfshirjes sociale te shtresave vulnerabel	Plan veprimi për nxitjen dhe diversifikimin e punësimit të grave	Gratë	2016	15 000	Bashkia	Bashkia Donatorë Biznes	Metoda e investimeve publike ose e përcaktuara nga donatori	Zhvillimi i aktiviteteve start up të grave në fushën e shërbimeve, artizanatit e turizmit dhe rritja e numrit të grave të punësuar
	Diversifikimi i punesimit dhe përmirësimi i përfshirjes sociale te shtresave vulnerabel	Projekti për nxitjen e frekuentimit të arsimit profesional	Të rinjtë	2017	1 800	Bashkia	Bashkia Donatorë Biznes	Metoda e investimeve publike ose e përcaktuara nga donatori	Rritja e numrit të nxënësve që kanë interes ose frekuentojnë shkollat profesionale
Qeverisjes e mire nepermetet per miresimet te sherbimeve ndaj qytetareve	Qeverisjes e mire nepermetet per miresimet te sherbimeve ndaj qytetareve	Studimi mbi tregun e punës dhe tendencat e orientimit të tij		2017	2 000	Bashkia	Bashkia Donatorë Biznes	Metoda e investimeve publike ose e përcaktuara nga donatori	Evidentimi i nevojave të tregut të punës për burime njerëzore
	Qeverisjes e mire nepermetet per miresimet te sherbimeve ndaj qytetareve	Rikonstruksioni i Bashkisë Bulqizë	Administrata	2016	10 530	Bashkia	Bashkia Bulqizë Donatorë	Metoda e investimeve publike	Përmirësimi i kushteve të punës të punonjësve të administratës
	Qeverisjes e mire nepermetet per miresimet te sherbimeve ndaj qytetareve	Ngritja e agjencisë së zhvillimit vendor	Zyra e Progr- Zhvillimit	2017	5000	Bashkia	Bashkia Donatorë	Metoda e specifikuar nga donatori	Ngritja e instrumentave të zhvillimit
Qeverisjes e mire nepermetet per miresimet te sherbimeve ndaj qytetareve	Rikonstruksioni i zyrave të Njësisë Administrative Zerqan	Nëpunësit e njësisë administrative 11 punonjës	2017	17538	Bashkia	Bashkia Fondi i Rajoneve MSHÇV	Metoda e investimeve publike	Përmirësimi i kushteve të punës dhe rritja e cilësisë së shërbimit ndaj qytetarëve	



Plani POZHL në kuadrin planifikimit strategjik dhe territorial

Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” u jep bashkive kompetenca dhe përgjegjësi në lidhje me hartimin e planeve strategjike e të programeve për zhvillimin ekonomik vendor; organizimin e shërbimeve në mbështetje të zhvillimit ekonomik; planifikimin, administrimin, zhvillimin dhe kontrollin e territorit; mbështetjen për zhvillimin e biznesit të vogël; si dhe për planifikimin, administrimin, zhvillimin e disa shërbimeve kryesore për qytetarët dhe të infrastrukturës vendore rrugore/arsimore/shëndetsore/bujqësore etj.

Në referencë të këtij ligji:

- POZHL mori në konsideratë të gjithë dokumentat e planifikimit dhe zhvillimit në përdorim nga ish-njësitë vendore.
- POZHL nxori në pah vizionin, prioritetet operacionale dhe projektet prioritare të komunitetit të bashkisë Bulqizë duke i dhënë një instrument të rëndësishëm afatshkurtër për planifikimin dhe zhvillimin vendor. Ai shtroi si detyra për të ardhmen hartimin dhe miratimin e (i) Strategjisë për zhvillimin ekonomik, (ii) Planit vendor për zhvillimin e territorit, (iii) Planit të veprimit mbi zhvillimin e turizmit të natyrës dhe rural, (iv) Planit vendor për menaxhimin e mbetjeve, (v) Paktit territorial të punësimit.
- POZHL është në harmoni me dokumentat strategjike. POZHL është në harmoni, në zbërthim dhe zbatim të qëllimit strategjik 3 “Nxitja e zhvillimit të qëndrueshëm vendor”, të përcaktuar në Strategjinë Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2015–2020; të tre objektivave të reformës administrative-territoriale; të Strategjinë Kombëtare të Furnizimit me Ujë 2011-2017; të Strategjisë Ndërsektoriale për Zhvillimin Rural dhe Bujqësor 2014-2020; të Strategjisë Kombëtare për Punësim dhe Aftësim 2014-2020; të dokumentit të politikave për planifikimin dhe zhvillimin e territorit në Shqipëri 2014- 2018; si dhe të Strategjisë së zhvillimit rajonal Dibër.

8.

Anekset

ANEKS 1

KRITERE VLERËSIMI PËR IDENTIFIKIMIN E PROJEKTEVE PRIORITARE

Në funksion të identifikimit të projekteve pjesë të Planit Operacional të Zhvillimit përzgjedhja e tyre do të bazohet në modelin e prioritarizimit, proces i cili është udhëhequr nga disa kritere vlerësimi:

Projekti kontribuon në masat e Strategjive të Zhvillimit (të ish-njësive vendore, qarkut, sektoriale e ndërsektoriale).

Projekti adreson prioritetet strategjike të dokumentave strategjikë (p.sh. të zhvillimit rajonal, të planifikimit dhe zhvillimit të territorit, të turizmit, të pyjeve dhe kullotave, të zonave të mbrojtura, të bujqësisë, të sipërmarrjes së lirë etj).

Projekti mbështet sektorin prioritar të evidentuara në bashki.

Projekti stimulon sektorin privat me nisma të ngjashme.

Projekti adreson zgjidhjen e problemeve sociale dhe kontribuon në përfshirjen sociale.

Projekti mobilizon potenciale zhvillimi në bashki.

Projekti ka efekt zinxhir në sektorë të tjerë dhe në zhvillimin ekonomik në bashki dhe rajon (potenciali ekonomik).

Projekti adreson një emergjencë në bashkia.

Projekti nxit mjedis të qëndrueshëm.

Projekti ka impakt rajonal dhe më gjerë.

ANEKS 2

FISHË PROJEKTET

Titulli/Emërtimi i projektit	Ngritja e agjencisë së zhvillimit vendor
Tipi i projektit	Zhvillim ekonomik
Vendndodhja e projektit	Bashkia Bulqizë
Buxheti total i projektit	5 000 000 ALL
Kontributi në rastin e bashkëfinancimit nga qeveria vendore	Bashkia 30%
Përshkrimi i projektit	<p>Resurset, pozita gjeografike dhe kushtet klimatike janë favorizuese për një zhvillim të qendrueshëm vendor në Bulqizë. Bashkia ka resurse dhe potenciale të përshtatshme për zhvillimin e bujqësisë, blegtorisë, industrisë minerare, shërbimeve, turizmit, peshkimit dhe të grumbullimit të bimëve mjekësore. Megjithatë, ajo është një nga bashkitë më të varfëra në vend me popullsi që ka tendencë largimi, me varfëri dhe përjashtim social shqetësues. Rreth 38.5% e forcës së punës 15 vjeç e lart është e papunë, niveli i papunësisë tek gratë dhe të rinjtë është shumë i lartë. Rreth 37% e familjeve të Hasit janë në skemën e programit të ndihmës ekonomike. Kjo diferencë mes potencialeve dhe realitetit vjen si pasojë e (i) mungesës së kapaciteteve njerëzore dhe institucionale për planifikimin dhe shfrytëzimin e resurseve (ii) mungesës së praktikave dhe nismave të partneritet publik -privat.</p> <p>Në asnjë nga ish NJQV-të pjesë përbërëse të bashkisë Bulqizë nuk ka patur agjenci të zhvillimit vendor. Bashkia ka në funksionet e veta hartimin dhe zbatimin e programeve për zhvillimin ekonomik vendor. Bashkia mund të përfitojë fonde për projekte zhvillimi nga fondi i rajoneve, fondet e turizmit, projektet IPA, komponenti i bashkëpunimit ndërkuftar me Kosovën, Malin e Zi si dhe fonde nga donatorë dhe agjensi të ndryshme zhvillimi etj.</p> <p>Zhvillimi vendor është një proces i ndërlikuar, i cili kërkon një partneritet të detyrueshëm midis qeverisë vendore, komunitetit sipërmarrës dhe shoqërisë civile për një planifikim dhe veprim strategjik. Zhvillimi vendor kërkon një vizion “udhëheqës” dhe një qasje largpamëse për të përcaktuar rrugën drejt të ardhmes dhe për të formësuar sjelljet e aktorëve të tjerë të cilët nuk janë në kontrollin e qeverisjes vendore. Përmeshja e këtij roli kërkon aftësi, ekspertizë, struktura fleksibël dhe efikasë si dhe marrëveshje të ndryshme organizative për sektorë, kohë dhe hapësira të ndryshme.</p> <p>Një nga instrumentat më të mirë për përmeshjen e detyrave të sipërcituara është ngritja e një agjencie të zhvillimit vendor, e cila me rolin e saj në disa fusha siguron:</p> <ul style="list-style-type: none"> (i) vizion dhe plane afatgjata për territorin, zhvillimin dhe kohezionin shoqëror. (ii) nxitjen e dialogut ndërmjet aktorëve vendorë.
Qëllimi dhe objektivat	<p>Zhvillimi i qendrueshëm vendor nëpërmjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Krijimit të një agjencie të zhvillimit vendor ▪ Nxitjes së dialogut ndërmjet aktorëve vendorë ▪ Nxitjes dhe mbështetjes së qasjeve inovative
Rezultatet e pritshme	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Ngritja agjencisë së zhvillimit vendor
Rendi prioritar	Projekti është në rendin prioritar për vitin 2017

Qendrueshmëria e projektit	Pranë bashkisë do të ngrihet zyra e programim zhvillimit, e cila në fushat e veprimtarisë së saj në fillim ka: <ul style="list-style-type: none"> ▪ Evidentimin e aktorëve në territor për zhvillimin vendor ▪ Inkurajimi i qasjeve zhvillimore nga posht lart ▪ Promovimin i partneritetit publik e privat ▪ Mbështetja e ideve innovative ▪ Rritjen e kapaciteteve të agjencisë së zhillimit
Aktivitetet e projektit	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Evidentimi i aktorëve në territor për zhvillimin vendor ▪ Promovimi i partneritetit publik e privat ▪ Përcaktimi i misionit, rolit dhe i fushës së veprimtarisë së agjencisë së zhvillimit. ▪ Realizimi i marrëveshjeve me aktorët e ndryshëm të zhvillimit ▪ Miratimi i rregullave nga këshilli i bashkisë ▪ Regjistrimi në gjykatë ▪ Rritja e kapaciteteve
Vlerësimi i ndikimit në mjedis	Nuk ka ndikim në mjedis
Përshkrim për gatishmërinë e projektit për zbatim	Projekti ndodhen në fazën e projekt idesë. Hapi i parë që kërkohet është hartimi i një plan veprimi, përcaktimi i misionit, rolit dhe fushës së veprimtarisë së agjencisë, gjetja e partnerëve mbështetës si dhe e fondeve përkatëse.
Planifikimi vendor, ndërvendor, kombëtar	Projekti në formën e ngritjes së një strukture për hartim projektësh është në matricën e projekteve të të gjithë planeve të zhvillimit vendor të ish-njësie.

Titulli/Emërtimi i projektit	Sistemim asfaltim i rrugës në fshatin Dushaj
Tipi i projektit	Infrastrukturë
Vendndodhja e projektit	Njësia Administrative Fushë-Bulqizë
Buxheti total i projektit	55 440 000 ALL
Kontributi në rastin e bashkëfinancimit nga qeveria vendore	Bashkia 0%
Përshkrimi i projektit	<p>Segmenti rrugor i propozuar kapjerrësi 2-12%, me gjerësi 3 m, i shtruar më çakull dhe i kalueshëm me shumë vështirësi. Në shumë pjesë ka mungesë të shtresave rrugore, nuk ekzistojnë bankinat, ka mungesë të elementëve të domosdoshëm të infrastrukturës rrugore, ujrat rrjedhin në trup të rrugës pasi kanalet anësore dhe veprat e artit mungojnë plotësisht. Rruga asnjëherë nuk ka pasur një përmirësim apo rikonstruksion tërësor, por vetëm mirëmbajtje rutinë. Gjendja e keqe e rrugës është një pengesë serioze për:</p> <ul style="list-style-type: none"> (i) transportin e njerëzve dhe të mallrave (ii) aksesin ndaj shërbimeve bazë (iii) punësimin dhe zhvillimin ekonomik (iv) lëvizjen e nxënësve për në shkollë <p>Në sistemim asfaltim parashikohet të përfshihet një segment ku pjesa kaluese të ketë asfalt me gjerësi 3.5 m dhe në të dyja anët bankinë me gjerësi 2 x 0.50 m, vepra arti, kanal anësor, mure pritës dhe mbajtës, si dhe kalime me tombino.</p> <p>Përfitues të drejtëpërdrejtë do të jenë 500 banorë.</p>

Qëllimi dhe objektivat	Qëllim i projektit është përmirësimi i cilësisë së jetësës, me objektiv <ul style="list-style-type: none"> ▪ Të përmirësohet infrastruktura e transportit ▪ Të përmirësohet aksesit në shërbimet bazë ▪ Të përmirësohet aksesit në tregjet e zonës ▪ Të rriten mundësitë për zhvillim social-ekonomik
Rezultatet e pritshme	Ndër rezultatet e pritshme janë: <ul style="list-style-type: none"> ▪ Ulje të kostove të transportit ▪ Rritja e të ardhurave dhe përmirësim i mirëqenies ekonomike ▪ Rritja e mundësive për punësim dhe të aksesit në tregun e punës ▪ Frenim i largimit të popullsisë ▪ Uljen e shpenzimeve për mirëmbajtjen e automjeteve ▪ Gjallërim të jetës sociale
Rendi prioritar	Projekti është në rendin prioritar për vitin 2016
Qendrueshmëria e projektit	Pranë bashkisë do të ngrihet njësi për administrim dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës rrugore lokale. Fondi për administrimin dhe mirëmbajtjen e rrugës do të parashikohet çdo vit në buxhetin e bashkisë.
Aktivitetet e projektit	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Aplikimi tek fondi i Rajoneve apo tek ndonjë donator tjetër ▪ Miratimi i lejeve administrative ▪ Zbatimi i projektit
Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis	Ka ndikim në mjedis, por në bazë të masave zbutëse të propozuar në studimin e ndikimit në mjedis do të minimizohet ndikim
Përshkrim për gatishmërinë e projektit për zbatim	Projekti për përmirësimin e këtij segmenti është i hartuar dhe ndodhet në bashki me të gjithë specifikimet teknike, relacionin, preventivin, projektit e zbatimit dhe studimin e ndikimit në mjedis.
Planifikimi vendor, ndërvendor, kombëtar	Është miratuar si prioritet me Vendim të këshillit të bashkisë nr. 1 datë 15.01.2013

Titulli/Emërtimi i projektit	Sistemim asfaltim i rrugës Ura e Serbinit-Shtushaj
Tipi i Projektit	Infrastrukturë
Vendndodhja e projektit	Njësia Administrative Shupenzë
Buxheti total i projektit	224 988 133 ALL
Kontributi në rastin e bashkëfinancimit nga qeveria vendore	Bashkia 0%
Përshkrimi i projektit	<p>Segmenti rrugor i propozuar lidh fshatin Shtushaj me qendrën administrative Shupenzë dhe me Bashkinë Bulqizë. Segmenti rrugor me gjatësi 5293 m dhe me gjerësi 3 m është i shtruar më çakull dhe i kalueshëm me shumë vështirësi. Në shumë pjesë ka mungesë të shtresave rrugore, nuk ekzistojnë bankinat, ka mungesë të elementëve të domosdoshëm të infrastrukturës rrugore, ujrat rrjedhin në trup të rrugës pasi kanalet anësore dhe veprat e artit mungojnë plotësisht. Rruga asnjëherë nuk ka pasur një përmirësim apo rikonstruksion tërësor, por vetëm mirëmbajtje rutinë. Gjendja e keqe e rrugës është një pengesë serioze për:</p> <ul style="list-style-type: none"> (i) transportin e njerëzve dhe të mallrave (ii) aksesin ndaj shërbimeve bazë (iii) punësimin dhe zhvillimin ekonomik (iv) lëvizjen e nxënësve për në shkollë <p>Në sistemim asfaltim parashikohet të përfshihet një segment me gjatësi 5293 ml, pjesa kaluese me asfalt me gjerësi 5 m dhe në të dyja anët bankinë me gjerësi 2 x 0.50 m dhe kanalet anësore për ujrat e shirave. Përfitues të drejtëpërdrejtë do të jenë 8000 banorë.</p>
Qëllimi dhe objektivat	<p>Qëllim i projektit është përmirësimi i cilësisë së jetësës, me objektivat</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Të përmirësohet infrastruktura e transportit ▪ Të përmirësohet aksesin në shërbimet bazë ▪ Të përmirësohet aksesin në tregjet e zonës ▪ Të rriten mundësitë për zhvillim social-ekonomik
Rezultatet e pritshme	<p>Ndër rezultatet e pritshme janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Ulje të kostove të transportit ▪ Rritja e të ardhurave dhe përmirësimi i mirëqenies ekonomike ▪ Rritja mundësive për punësim dhe të aksesit në tregun e punës ▪ Frenim i largimit të popullsisë ▪ Uljen e shpenzimeve për mirëmbajtjen e automjeteve ▪ Gjallërim të jetës sociale
Rendi prioritar	Projekti është në rendin prioritar për vitin 2016
Qendrueshmëria e projektit	Pranë bashkisë do të ngrihet njësi për administrimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës rrugore lokale. Fondi për administrimin dhe mirëmbajtjen e rrugës do të parashikohet çdo vit në buxhetin e bashkisë.
Aktivitetet e projektit	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Aplikimi tek fondi i Rajoneve apo tek ndonjë donator tjetër ▪ Miratimi i lejeve administrative ▪ Zbatimi i projektit
Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis	Ka ndikim në mjedis, por në bazë të masave zbutëse të propozuar në studimin e ndikimit në mjedis do të minimizohet ndikim
Përshkrim për gatishmërinë e projektit për zbatim	Projekti për përmirësimin e këtij segmenti është i hartuar dhe ndodhet në bashki me të gjithë specifikimet teknike, relacionin, preventivin, projektit e zbatimit dhe studimin e ndikimit në mjedis.

Titulli/Emërtimi i projektit	Ndërtim i urës tre-çezmat Zerqan
Tipi i projektit	Infrastrukturë
Vendndodhja e projektit	Njësia Administrative Zerqan
Buxheti total i projektit	29 891 793 ALL
Aktivitetet e projektit	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Hartimi i projektit ▪ Lobimi për identifikimin dhe koordinimin e kontributeve të donatorëve ▪ Zbatim, monitorim.
Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis	Nuk ka ndikim.
Përshkrim për gatishmërinë e projektit për zbatim	Projekt-ide
Planifikimi vendor, ndërvendor, kombëtar	Pjesë e POZHL Bulqizë.

Titulli/Emërtimi i projektit	Nxitja e frekuentimit të arsimit profesional nga të rinjtë
Tipi i projektit	Arsim/Burime njerëzore
Vendndodhja e projektit	Bashkia Bulqizë, Qarku Dibër
Buxheti total i projektit	1 800 000 ALL
Kontributi në rastin e bashkëfinancimit nga qeveria vendore	Bashkia 5 %

Përshkrimi i projektit	Në kushtet e nevojave për diversifikim të tregut të punës në Bashkinë Bulqizë drejt profesioneve dhe zejeve të reja, përgatitja e kuadrove të mesme të profilit profesional merr rëndësi të veçantë. Megjithatë, interesi i të rinjve për arsimin profesional nuk përputhet me nevojat e tregut dhe në këto kushte del si domosdoshmëri informimi i tyre në lidhje me mundësitë dhe perspektivën për punësim të shpejtë që hap studimi në një degë të arsimit profesional. Informimi dhe promovimi mbi përfitimet e arsimit profesional është një investim për të ardhmen e të rinjve dhe ka funksion rregullator për tregun e punës. Cikle workshopesh mbi llojet, rëndësinë, perspektivat dhe informacionet mbi oferta punësimi brenda dhe jashtë Shqipërisë në profesione të ndryshme do të përbëjnë bazën e fushatës, e cila do të mbështetet nga pushteti vendor, subjekte private që ofrojnë vende pune, shkollat e arsimit profesional të qarkut, donatorë të huaj dhe zyra e punës.
Qëllimi dhe objektivat	Nxijtja e frekuentimit të arsimit profesional nga të rinjtë në funksion të nevojave të tregut të punës dhe punësimit të të rinjve. <ul style="list-style-type: none"> ▪ Evidentimi i përparësive të studimit në degë të arsimit profesional ▪ Evidentimi i nevojave të tregut të punës brenda dhe jashtë Shqipërisë për profesione dhe zeje të ndryshme ▪ Rritje e numrit të nxënësve që kanë interes të ose frekuentojnë shkollat profesionale në territorin e qarkut Dibër ▪ Rritje e punësimit nga nxënësit që mbarojnë shkollën
Rezultatet e pritshme	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Nxënës të informuar mbi përparësitë e studimit në degë të arsimit profesional ▪ Nxënës të informuar mbi mundësitë e punësimit brenda dhe jashtë Shqipërisë në profesione dhe zeje të ndryshme ▪ Numër i rritur i nxënësve që kanë interes të ose frekuentojnë shkollat profesionale ▪ Numër i lartë i të punësuarve me arsim profesional
Rendi prioritar	2
Qendrueshmëria e projektit	Fushata që do të shtrihet në të gjitha njësitë e bashkisë do të përsëritet çdo vit shkollor në koordinim me Zyrën e Punës me mbështetjen e bashkisë dhe kontribut të shkollave profesionale të qarkut.
Aktivitetet e projektit	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Hartimi i projektit ▪ Lobimi për fonde ▪ Implementimi i projektit ▪ Monitorimi i zbatimit
Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis	Asnjë ndikim
Përshkrim për gatishmërinë e projektit për zbatim	
Planifikimi vendor, ndërvendor, kombëtar	Pjesë e POZHL Bulqizë

Titulli/Emërtimi i projektit	Studim mbi tregun e punës dhe tendencat e orientimit të tij
Tipi i projektit	Qeverisje e mirë/Politika sociale
Vendndodhja e projektit	Bashkia Bulqizë
Buxheti total i projektit	2 000 000 ALL

Kontributi në rastin e bashkëfinancimit nga qeveria vendore	Bashkia 10 %
Përshkrimi i projektit	<p>Aktivitetet kryesore ekonomike që ushtrohen në territorin e Bashkisë Bulqizë janë industria minerare, shfrytëzimi i pyjeve, hidrocentralet, blegtoria dhe bujqësia, grumbullimi i bimëve mjekësore, shërbimet etj. Territori karakterizohet nga peizazhi i bukur, klima dhe mjedisi malor, resurse të pasura kulturore e natyrore që përbëjnë potenciale për zhvillimin e turizmit. Megjithë këto resurse të mëdha, burimi kryesor i të ardhurave vjen nga puna në minierë, bujqësi dhe blegtoria duke lënë në hije drejtime të tjera të ekonomisë me potencial të dukshëm zhvillimi.</p> <p>Për të hartuar politika të diversifikimit të ekonomisë dhe punësimit, pushteti vendor ka nevojë të jetë në dijeni të gjendjes aktuale të punësimit, raportin midis ofertës dhe kërkesës për vende pune, arsimin dhe kualifikimet e punëkërkuësve aktualë. Gjithashtu kërkohet zhvillimi i një skenari të të ardhmes, në përputhje dhe me drejtimet prioritare të zhvillimit dhe diversifikimit të synuar të ekonomisë në Bulqizë. Krahasimi i gjendjes aktuale me skenarin e projektuar të të ardhmes, do të vërë në dukje nevojat që duhet të plotësohen për burime njerëzore, të kualifikuara e specializuara sipas drejtimeve ku synohet të zhvillohet Bashkia e re e Bulqizës</p>
Qëllimi dhe objektivat	<p>Identifikimi i potencialit të burimeve njerëzore në Bashkinë Bulqizë dhe orientimi i tij drejt tendencave të zhvillimit të ekonomisë dhe tregut</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Evidentimi i kapaciteteve të burimeve njerëzore në Bashkinë Bulqizë ▪ Evidentimi i nevojave të tregut të punës për burime njerëzore ▪ Përcaktimi i tendencave të këtyre nevojave për të ardhmen, në përputhje me prioritetet e diversifikimit të ekonomisë dhe tregut të punës në Bulqizë ▪ Hartimi i konkluzioneve e rekomandimeve për pushtetin vendor
Rezultatet e pritshme	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Kapacitetet e burimeve njerëzore në bashkinë Bulqizë të listuara ▪ Nevojat e tregut të punës për burime njerëzore, të evidentuara ▪ Tendencat e këtyre nevojave, në përputhje me prioritetet e diversifikimit të ekonomisë dhe tregut të punës në Bulqizë, të përcaktuara ▪ Konkluzione e rekomandime për pushtetin vendor
Rendi prioritar	1
Qendrueshmëria e projektit	Databaza e krijuar do të pasurohet e përditësohet nga Zyra e Punës në bashki. Projekti do të ketë gjithnjë përkrahje nga pushteti vendor, donatorët dhe shoqëria civile.
Aktivitetet e projektit	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Hartimi i projektit ▪ Lobimi për identifikimin dhe koordinimin e kontributeve të donatorëve ▪ Zbatim, monitorim
Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis	Nuk ka ndikim.
Përshkrim për gatishmërinë e projektit për zbatim	Projekt-ide
Planifikimi vendor, ndërvendor, kombëtar	Pjesë e POZHL Bulqizë

Titulli/Emërtimi i projektit	Rehabilitimi i kurorës së gjelbër të qytetit Bulqizë
Tipi i projektit	Shërbime/Mjedis
Vendndodhja e projektit	Qyteti Bulqizë
Buxheti total i projektit	28 000 000 ALL
Kontributi në rastin e bashkëfinancimit nga qeveria vendore	Bashkia 20 %
Përshkrimi i projektit	<p>Bulqiza është krijuar si një qytet minatorësh për shkak të shfrytëzimit të mineralit të kromit dhe si rrjedhojë ka një sipërfaqe të vogël të gjelbër. Sipërfaqja e gjelbër e qytetit është 10500m² nga këto janë rreth 200 copë pemë dekorative pishë e butë, plep i egër, ligustër, bli dhe gështenjë e kalit. Pyje dhe kullota të transferuara me VKM nr.375, datë 27.03.2008 për Bashkinë Bulqizës janë 2096.5 ha pyje, kullota 324.5 ha. Aktualisht kurora e gjelbër e qytetit është shkatëruar dhe djegur. Kjo kurorë është dëmtuar nga edhe nga shfrytëzimi i minierës së kromit duke mos respektuar bazat ligjore të shfrytëzimit të kromit. Dëmtimet kanë sjellë si pasojë ashpërsimin e klimës, shpyllëzimi, erozionin e egër dhe prishjen e imazhit të qytetit. Prandaj lind nevoja e rehabilitimit të kësaj kurore që do ti japë vlerë peizazhit të qytetit dhe do ta bëjë më të banueshëm, duke rritur edhe numrin e vizitorëve dhe turistëve.</p>
Qëllimi dhe objektivat	<p>Përmirësimi i cilësisë së jetësës së banorëve nëpërmjet rehabilitimit të kurorës së gjelbër të qytetit Bulqizë</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Rritje të sipërfaqeve të gjelbërta të qytetit ▪ Përmirësimi i dukurive të erozionit dhe zbutja e klimës ▪ Përmirësimi imazhit të qytetit ▪ Shtimi i numrit të turistëve dhe vizitorëve
Rezultatet e pritshme	<p>Nga ndërhyrja përfitojnë banorët e qytetit dhe bizneset pranë zonave të gjelbra.</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Sipërfaqe të gjelbërta të qytetit të rritura ▪ Erozion i ndaluar dhe klimë e zbutur ▪ Imazh i qytetit i përmirësuar ▪ Numër i shtuar i turistëve dhe vizitorëve
Rendi prioritar	1
Qendrueshmëria e projektit	<p>Projekti do të financohet me fondet e bashkisë, qeverisë dhe donatorëve dhe do të administrohet nga bashkia. Rritja e të ardhurave të biznesit nga turistët dhe vizitorët do të sjellë edhe rritjen e të ardhurave të qeverisjes vendore, prandaj projekti konsiderohet si i qendrueshëm në kohë.</p>

Aktivitetet e projektit	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Hartimi i projektit ▪ Implementimi i tij. ▪ Monitorimi i implementimit
Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis	NM është pozitiv, përmirësimi i sipërfaqeve të gjelbra ka ndikim të drejtpërdrejtë pozitiv.
Përshkrim për gatishmërinë e projektit për zbatim	Projekt-ide
Planifikimi vendor, ndërvendor, kombëtar	Projekti është pjesë e POZHL Bulqizë.

Titulli/Emërtimi i projektit	Ndërtimi i një kulle vrojtimi për pyjet
Tipi i projektit	Shërbime/Mjedis
Vendndodhja e projektit	Në majën e malit më të lartë të bashkisë Bulqizë
Buxheti total i projektit	25 200 000 ALL
Kontributi në rastin e bashkëfinancimit nga qeveria vendore	Bashkia 20 %
Përshkrimi i projektit	Të transferuara me VKM nr.375, datë 27.03.2008 për Bashkinë e Bulqizës janë 2096.5 ha pyje, 324.5 ha kullota. Aktualisht kurora e gjelbër e qytetit është shkatëruar dhe djegur. Përsa i përket pyjeve, ato janë dëmtuar dhe po shkatërrohen çdo ditë nga keqbërësit. Prerjet e paligjëshme janë problemi dhe shqetësimi më i madh që haset. Pyjet janë dëmtuar nga edhe nga shfrytëzimi i minierës së kromit duke mos respektuar bazat ligjore të shfrytëzimit të kromit. Dëmtimet kanë sjellë si pasojë ashpërsimin e klimës, shpyllëzimin, erozionin e egër dhe prishjen e imazhit të zonës. Prandaj në mënyrë urgjente duhet të ndërtohet një kullë vrojtimi për të kontrolluar dhe vrojtuar pyjet nga lart dhe duke ju shërbyer edhe turistëve për të vizituar zonat më të bukura të pyjeve dhe bukurive natyrore.
Qëllimi dhe objektivat	Mbrojtja e mjedisit dhe nxitja e turizmit nëpërmjet ndërtimit të kullës së vrotimit për të kontrolluar pyjet e bashkisë Bulqizë <ul style="list-style-type: none"> ▪ Ndërtimi i kullës së vrotimit me të gjitha pajisjet teknike ▪ Monitorimi i kujdesshëm i situatës së pyjeve në Bulqizë ▪ Pakësim i dëmtimeve të pyjeve dhe përmirësimi i mjedisit ▪ Shtimi i numrit të turistëve dhe vizitorëve
Rezultatet e pritshme	Nga ndërhyrja përfitojnë banorët, turistët, vizitorët si dhe bizneset pranë zonave të gjelbra. <ul style="list-style-type: none"> ▪ Kulla e vrotimit funksionale dhe me të gjitha pajisjet teknike. ▪ Hotspotet e identifikuar, monitoruara dhe marrja e masave përkatëse ▪ Pyje të shëndetshme dhe mjedis i përmirësuar ▪ Numër i shtuar i turistëve dhe vizitorëve
Rendi prioritar	1

Qendrueshmëria e projektit	Projekti do të financohet me fondet e bashkisë, qeverisë dhe donatorëve dhe do të administrohet nga Drejtoria Pyjore. Rritja e të ardhurave të biznesit nga turistët dhe vizitorët do të sjellë edhe rritjen e të ardhurave të qeverisjes vendore, prandaj projekti konsiderohet si i qendrueshëm në kohë.
Aktivitetet e projektit	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Hartimi i projektit ▪ Implementimi i tij ▪ Monitorimi i implementimit
Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis	NM është pozitiv, përmirësimi i sipërfaqeve të gjelbra ka ndikim të drejtpërdrejtë pozitiv.
Përshkrim për gatishmërinë e projektit për zbatim	Projekt-ide
Planifikimi vendor, ndërvendor, kombëtar	Projekti është pjesë e POZHL Bulqizë

Titulli/Emërtimi i projektit	Projekt pilot për ndarjen e mbetjeve urbane në burim në qytetin Bulqizë
Tipi i projektit	Mjedis/Shërbime
Vendndodhja e projektit	Qyteti Bulqizë
Buxheti total i projektit	8 400 000 ALL
Kontributi në rastin e bashkëfinancimit nga qeveria vendore	Bashkia 60 %
Përshkrimi i projektit	Bulqiza është një qytet që ka probleme me menaxhimin e mbetjeve urbane, pasi duhet të bëhet ndarja nga prodhimi i tyre. Kjo situatë nuk është e aplikueshme pasi mungojnë kazanë ndarës për çdo mbetje dhe mungon riciklimi i tyre. Llojet e disponueshme të mbetjeve urbane janë kryesisht mbetje si: organike, dru, letër, plastike me densitet të ulët dhe me densitet të lartë, qelq, tekstile, metale ferroke, dhe jo ferroke, mbetje nga shëndetësia, goma, inerte, mbetje nga produkte sanitare, mbetje elektrike dhe nga pajisje elektronike. Të gjitha këto mbetje depozitohen së bashku duke bërë që volumi i tyre të jetë shumë i madh edhe në mungesë të riciklimit. Prandaj lind si nevojë nisma e hartimit të një projekti pilot për ndarjen e mbeturinave dhe vendosjen e kazaneve të posaçëm në disa pika të qytetit ku qytetarët të depozitojnë në mënyrë të ndarë mbeturinat. Kësaj nisme duhet ti paraprijë një fushatë informuese dhe sensibilizuese.
Qëllimi dhe objektivat	<p>Përmirësimi dhe modernizimi i shërbimit të menaxhimit të mbetjeve në Bulqizë nëpërmjet grumbullimit të ndarë të mbetjeve.</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Edukimi i qytetarëve për ndarjen e mbeturinave sipas llojit ▪ Depozitimi i ndarë nëpërmjet krijimit të rrjetit të venddepozitimeve sipas llojit në një pjesë të qytetit ▪ Rritja e kulturës qytetare edhe në pjesën tjetër të qytetit ▪ Gjallërimi i industrisë ricikluese ▪ Përmirësimi i gjendjes së pastrimit

Rezultatet e pritshme	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Qytetarë të edukuar për ndarjen e mbeturinave sipas llojit ▪ Rrjet i ngritur i venddepozitimeve sipas llojit në një pjesë të qytetit ▪ Kulturë qytetare e përmirësuar edhe në pjesën tjetër të qytetit ▪ Punësim nga industria ricikluese ▪ Gjendja e mjedisit dhe pastrimit e përmirësuar
Rendi prioritar	2
Qendrueshmëria e projektit	Ndërmarrja e pastrimit të bashkisë do të zbatohet projektin dhe bashkia do ta mirëmbajë me fondet e taksës së pastrimit.
Aktivitetet e projektit	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Hartimi i projektit ▪ Lobimi për fonde ▪ Implementimi i projektit ▪ Monitorimi i zbatimit
Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis	Shumë pozitiv, mjedis më i pastër.
Përshkrim për gatishmërinë e projektit për zbatim	Projekt-ide
Planifikimi vendor, ndërvendor, kombëtar	Pjesë e POZHL Bulqizë.

Titulli/Emërtimi i projektit	Ndërtimi i argjinaturës në Lumin Drini i Zi, Gjoricë
Tipi i projektit	Infrastrukturë/Mjedis
Vendndodhja e projektit	Gjoricë e Poshtme, Bulqizë
Buxheti total i projektit	42 000 000 ALL
Kontributi në rastin e bashkëfinancimit nga qeveria vendore	Bashkia 2 %
Përshkrimi i projektit	Lumi Drin me rrjedhën e tij të rrëmbyeshme ka qenë dhe është problem i madh sidomos gjatë muajve të dimrit, duke dalë nga shtrati i tij dhe duke përmbytur familjet që janë përreth tij dhe tokën bujqësore. Gjithashtu ky lumë vazhdimisht gërryen brigjet dhe tokën anash tyre duke e pakësuar dhe hequr nga fondi pyjor dhe kullësor hektarë të tërë. Pronat e rreth 150 familjeve janë gjithmonë të pasigurta dhe të rrezikuara nga momenti në moment nga përmbytjet që mund të ju rrezikojë edhe jetën e njerëzve. Ky lumë kur del nga shtrati rrezikon mbi 156 ha tokë bujqësore. Ka pasur raste që përmbytjet nga lumi Drini i Zi kanë bërë që disa familje të braktisin përgjithmonë shtëpitë e tyre. Për këtë arsye lind si domosdoshmëri ndërtimi i 300m linear argjinaturë për mbrojtjen nga përmbytjet e banesave të 150 familjeve dhe 156 ha tokë bujqësore.
Qëllimi dhe objektivat	<p>Përmirësimi i sigurisë, mjedisit dhe cilësisë së jetesës së banorëve të njësisë Gjoricë nëpërmjet ndërtimit të argjinaturës së lumit Drini i Zi .</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Ndërtimi i argjinaturës dhe sigurimi i tokave nga përmbytja. ▪ Ulja e erozionit ▪ Përmirësimi i kushteve të jetesës së banorëve ▪ Përmirësimi i prodhimit të kulturave bujqësore ▪ Ndalimi i shpopullimit të zonës

Rezultatet e pritshme	Nga investimi për këtë projekt do të përfitojnë banorët dhe e gjithë bashkia për krijimin e njëmjedisi të sigurt. <ul style="list-style-type: none"> ▪ Argjinatura e ndërtuar dhe tokat e mbrojtura nga përmytja ▪ Erozion i ulur ▪ Kushte të mira jetese për banorët ▪ Prodhim i rritur i kulturave bujqësore ▪ Popullsia e zonës stabilizohet dhe rritet
Rendi prioritar	1
Qendrueshmeria e projektit	Projekti është i qendrueshëm sepse do të mirëmbahet nga komuniteti, dhe pushteti vendor e qendror.
Aktivitetet e projektit	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Hartimi i projektit teknik ▪ Identifikimi dhe koordinimi i kontributeve të donatorëve ▪ Zbatimi i punimeve ▪ Monitorimi i gjendjes.
Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis	NM është tepër pozitiv, mbrojtje nga erozioni.
Përshkrim për gatishmërinë e projektit për zbatim	Projekt-ide
Planifikimi vendor, ndërvendor, kombëtar	Projekti është pjesë e POZHL Bulqizë

RIKONSTRUKSIONI I KOPSHTIT NR. 1 LAGJA MINATORI, BASHKIA BULQIZË

Titulli/Emërtimi i projektit	Rikonstruksioni i kopshtit Nr. 1 Lagja Minatori, Bashkia Bulqizë
Tipi i projektit	Infrastrukturë
Vendndodhja e projektit	Njësia Qender
Buxheti total i projektit	21 002 490ALL
Kontributi në rastin e bashkëfinancimit nga qeveria vendore	10 % nga bashkia
Përshkrimi i projektit	<p>Objekti është godine një kateshe e ndertuar me mur guri, në të cilën edukohen mbi 60 fëmijë. Godina është në një gjendje jo të mirë për shkak të amortizimit ndër vite dhe prezencës së lagështirës.</p> <p><u>Vlerësimi fizik i objektit:</u> Sipas vlerësimit paraprak rezulton që:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Objekti nuk ka solete b/a - Catia është e dëmtuar dhe tavanet me lagështi - Dyert dhe dritaret të amortizuara - Dera e jashtme është e papërshtatshme (duroalumin) e për pasojë duhet zëvendësuar me dera të blinduar importi. - Kuzhina nuk është e pajisur me të gjitha elementet e nevojshme për funksionimin e saj (sobë gatimi, lavaman, kullonjse profesionale për enët e gatimit etj) - Të gjitha ambjentet e brendëshme të kopshtit paraqesin probleme me lagështinë - Dhomat e tualeteve janë tepër të amortizuara dhe nuk plotesojnë kushtet minimale teknike. - Dritaret nuk garantojnë kushtet e mirëqenies termike në ambjentet e brendëshme, për këtë arsye duhen zëvendësuar me dritare të reja plastike me dopio xham. - Suvatimet e jashtme e të brendëshme janë të degraduara. <p>Përfitues të drejtpërdrejtë do të jenë 60-80 fëmijë.</p>
Qëllimi dhe objektivat	<p>Qëllimi i projektit është përmirësimi i cilësisë së jetesës së fëmijëve, me objektivat</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Përmirësimi i ambjenteve të kopshtit ▪ Rritja e cilësisë së edukimit dhe komoditetit të fëmijëve ▪ Krijimi i një ambienti komod ▪ Krijimi i kushteve bashkohore
Rezultatet e pritshme	<p>Ndër rezultatet e pritshme janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Ambjente të rikostruktuar ▪ Edukimi i shëndoshe i brezave
Rendi prioritar	Projekti është në prioritetet e vitit 2016
Qëndrueshmëria e projektit	Pranë bashkisë do të ngrihet njësi për administrimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës lokale. Fondi për administrimin dhe mirëmbajtjen e objektit do të parashikohet çdo vit në buxhetin e Bashkisë.
Aktivitetet e projektit	<p>Për realizimin e projektit janë të nevojshëm:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Aplikimi tek fondi i Rajoneve apo tek ndonjë donator tjetër ▪ Miratimi i lejeve administrative ▪ Zbatimi i projektit
Vlerësimi i ndikimit në mjedis	Nuk ka ndikim në mjedis

Përshkrim për gatishmerinë e projektit për zbatim.	Projekti për përmirësimin e këtij objekti është i hartuar dhe ndodhet në Bashki me të gjithë specifikimet teknike, relacionin, preventivin, projektit e zbatimit dhe studimin e ndikimit në mjedis.
Planifikimi vendor, ndërvendor, kombëtar	Projekti është në listën prioritarë të miratuar me vendim të Këshillit Bashkiak në Mars 2016.

Titulli/Emërtimi i projektit	Sistemim Asfaltim Rruga Blloku i Poshtem, Lagja Minatori
Tipi i projektit	Infrastrukturë
Vendndodhja e projektit	Njësia Qender
Buxheti total i projektit	31 457 671 ALL
Kontributi në rastin e bashkëfinancimit nga qeveria vendore	2 % nga Bashkia
Përshkrimi i projektit	<p>Segmenti rrugor i propozuar është në një gjendje jo të mirë në të cilën mungojnë plotësisht shtresat rrugore dhe elementet e infrastruktures rrugore.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Kanalizimet e ujrave të zeza janë jashtë kushteve teknike dhe të amortizuara, herë pas herë bllokohen. - Kanalizimet e ujrave të bardha nuk egzistojnë - Rrjeti ndriçimit rrugor mungon <p>Rruga asnjëherë nuk ka pasur një përmirësim apo rikonstruksion tërësor por vetëm mirëmbajtje rutinë. Gjendja e keqe e rrugës është një pengesë serioze për (i) transportin e njerëzve dhe të mallrave, (ii) qasjen ndaj shërbimeve bazë (iii) punësimin dhe zhvillimin ekonomik etj. Objekti do të ketë një gjerësi të përgjithshme prej 7.50 m , dhe do të përbëhet nga :</p> <ul style="list-style-type: none"> - trupi i rruges me gjerësi 5.50 m - pjesa e asfaltuar me një pjerresë terthore, 5.00 m - në një anë kurbet betoni me gjerësi 0.50 m - trotuar në një anë 1x1.80m - në anën nga pallatet trotuari i ndërtesës, do të përbëjë 1.6m. <p>Përfutjes të drejtpërdrejtë do të jenë 5000 banorë.</p>
Qëllimi dhe objektivat	<p>Qëllimi i projektit është përmirësimi i cilësisë së jetesës, me objektivat</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Të përmirësohet infrastruktura e transportit ▪ Të përmirësohet qasja në shërbimet bazë ▪ Të rriten mundësitë për zhvillim social-ekonomik
Rezultatet e pritshme	<p>Ndër rezultatet e pritshme janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Rritja e të ardhurave dhe përmirësimi i mirëqenies ekonomike ▪ Rritje e mundësive për punësim dhe të qasjes në tregun e punës. ▪ Frenim i largimit të popullsisë ▪ Uljen e shpenzimeve për mirëmbajtjen e automjeteve ▪ Gjallërim të jetës sociale
Rendi prioritar	Projekti është në prioritetet e vitit 2016

Qëndrueshmëria e projektit	Pranë bashkisë do të ngrihet njësi për administrimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës rrugore lokale. Fondi për administrimin dhe mirëmbajtjen e rrugës do të parashikohet çdo vit në buxhetin e Bashkisë.
Aktivitetet e projektit	Për realizimin e projektit janë të nevojshëm: <ul style="list-style-type: none"> ▪ Aplikimi tek fondi i Rajoneve apo tek ndonjë donator tjetër ▪ Miratimi i lejeve administrative ▪ Zbatimi i projektit
Vlerësimi i ndikimit në mjedis	Ka ndikim në mjedis, por në bazë të masave zbutëse të propozuar në studimin e ndikimit në mjedis do të minimizohet ndikim
Përshkrim për gatishmerinë e projektit për zbatim.	Projekti për përmirësimin e këtij segmenti është i hartuar dhe ndodhet në Bashki me të gjithë specifikimet teknike, relacionin, preventivin, projektit e zbatimit dhe studimin e ndikimit në mjedis.
Planifikimi vendor, ndërvendor, kombëtar	Projekti është në listen prioritare të miratuar me vendim të Keshillit Bashkiak në Mars 2016.

Titulli/Emërtimi i projektit	Sistemim Asfaltim Rruga përballë Spitalit, Lagja Minatori
Tipi i projektit	Infrastrukturë
Vendndodhja e projektit	Njësia Qender
Buxheti total i projektit	16 465 512ALL
Kontributi në rastin e bashkëfinancimit nga qeveria vendore	2 % nga Bashkia
Përshkrimi i projektit	<p>Segmenti rrugor i propozuar është në një gjendje jo të mirë në të cilën mungojnë plotësisht shtresat rrugore dhe elementet e infrastruktures rrugore.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Kanalizimet e ujrave të zeza janë jashtë kushteve teknike, të amortizuar dhe herë pas here bllokohen. - Kanalizimet e ujrave të bardha nuk egzistojnë - Rrjeti ndriçimit rrugor është e dëmtuar <p>Rruga asnjëherë nuk ka pasur një përmirësim apo rikonstruksion tërësor por vetëm mirëmbajtje rutinë. Gjendja e keqe e rrugës është një pengesë serioze për (i) transportin e njerëzve dhe të mallrave, (ii) qasjen ndaj shërbimeve bazë (iii) punësimin dhe zhvillimin ekonomik etj. Objekti do të ketë parametrat e mëposhtëm :</p> <ul style="list-style-type: none"> - trupi i rrugës me gjerësi 6.0 m - pjesa e asfaltuar me një pjerresi tërthore 4.50 m - në një ane kunete betoni me gjerësi 0.50 m - trotuar në dy anë 2x1.50m <p>Përfitues të drejtpërdrejtë do të jenë 5000 banorë.</p>
Qëllimi dhe objektivat	<p>Qëllimi i projektit është përmirësimi i cilësisë së jetesës, me objektivat</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Të përmirësohet infrastruktura e transportit ▪ Të përmirësohet qasja në shërbimet bazë ▪ Të rriten mundësitë për zhvillim social-ekonomik

Rezultatet e pritshme	Ndër rezultatet e pritshme janë: <ul style="list-style-type: none"> ▪ Rritja e të ardhurave dhe përmirësim i mirëqenies ekonomike ▪ Rritje e mundësive për punësim dhe të qasjes në tregun e punës. ▪ Frenim i largimit të popullsisë ▪ Uljen e shpenzimeve për mirëmbajtjen e automjeteve ▪ Gjallërim të jetës sociale
Rendi prioritar	Projekti është ne prioritetet e vitit 2016
Qëndrueshmëria e projektit	Pranë bashkisë do të ngrihet njësi për administrimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës rrugore lokale. Fondi për administrimin dhe mirëmbajtjen e rrugës do të parashikohet çdo vit në buxhetin e Bashkisë.
Aktivitetet e projektit	Për realizimin e projektit janë të nevojshëm: <ul style="list-style-type: none"> ▪ Aplikimi tek fondi i Rajoneve apo tek ndonjë donator tjetër ▪ Miratimi i lejeve administrative ▪ Zbatimi i projektit
Vlerësimi i ndikimit në mjedis	Ka ndikim në mjedis, por në bazë të masave zbutëse të propozuar në studimin e ndikimit në mjedis do të minimizohet ndikim
Përshkrim për gatishmerinë e projektit për zbatim.	Projekti për përmirësimin e këtij segmenti është i hartuar dhe ndodhet në Bashki me të gjithë specifikimet teknike, relacionin, preventivin, projektit e zbatimit dhe studimin e ndikimit në mjedis.
Planifikimi vendor, ndërvendor, kombëtar	Projekti është ne listen prioritare te miratuar me vendim te Keshillit Bashkiak ne Mars 2016.

Titulli/Emërtimi i projektit	Ndërtimi i Tregut të Qytetit dhe të Shupenzës për tregëtimin e prodhimeve bujqesore e blegtorale
Tipi i projektit	Infrastruktura
Vendndodhja e projektit	Qyteti Bulqize dhe Njësia Administrative Shupenzë
Buxheti total i projektit	20 000 000 ALL
Kontributi në rastin e bashkëfinancimit nga qeveria vendore	10% nga Bashkia
Përshkrimi i Projektit	Për 25 vjet në qytetin e Bulqizës shitja e produkteve bujqesore e blegtorale nga tregtarët e vegjël dhe fermerët është bërë jashtë çdo kushti higjieno-sanitar. Tregtimi bëhet në një treg të improvizuar në lagjen “Minatori” në të majtë të rrugës që të çon për në qytetin e ri, produktet vendosen në tokë për tregtim dhe jashtë cdo lloj standarti. Nga autoritet vendore ndër vite ndërtimi i tregut është parë si prioritet por mungesa e fondeve nuk e ka mundësuar një gjë të tillë. Ndërtimi i tregut sot shihet si nevojë emergjente. Përfitues janë tregtarët e vegjël të qytetit dhe fermerët e zonave që sjellin për tregtim produktet e tyre. E njëta gjë vlen edhe për tregun e Shupenzës.

Qëllimi dhe objektivat	Qëllimi i projektit është rritja e qasjes në treg i tregtareve të vegjel dhe fermerve, me objektiv <ul style="list-style-type: none"> ▪ Përmirësimi i standarteve të tregtimit të produkteve. ▪ Rritja e cilësisë së shërbimit ndaj qytetarëve ▪ Rritja e të ardhurave të bashkisë
Rezultatet e pritshme	Ndër rezultatet e pritshme janë: <ul style="list-style-type: none"> ▪ Një treg i ndërtuar ▪ Standarte tregtimi të përmisuara ▪ Rritje e numrit të tregtarëve të vegjel dhe fermerve në treg. ▪ Siguria ushqimore e përmisuar ▪ Të ardhurat e bashkisë nga tregu të rritura
Rendi Prioritar	Projekti është në rendi prioritar 1
Qendrueshmëria e Projektit	Pranë bashkisë do të ngrihet njësi për administrimin dhe mirëmbajtjen e tregut e cila në partneritet me tregtarët e vegjel dhe fermerët do të siguroj mirëfunksionimin e tregut në vazhdimësi.
Aktivitetet e Projektit	Për realizimin e projektit janë të nevojshëm: <ul style="list-style-type: none"> ▪ Studimi i gjendjes dhe e fizibilitetit. ▪ Raporti i ndikimit në mjedis ▪ Gjetjen e truallit ▪ Hartimi i projektit teknik ▪ Ngritja e skemave të partneritetin publik privat ▪ Miratimi i lejeve administrative ▪ Zbatimi dhe monitorimi i projektit
Vlersimi i ndikimit ne mjedis	Nuk ka një raport vlersimi për ndikimin në mjedis
Përshkrim për gatishmerinë e projektit për zbatim.	Projekti ndodhen në fazën e projekt ides. Ka një vullnet nga autoritet e Bulqizës dhe një interes gjithnjë në rritje nga tregtarët e vegjël dhe fermerët për të kontribur në ndërtimin e tregut.
Planifikimi vendor,ndervendor dhe kombetar	Projekti ka qenë në listën e projekteve prioritare të vendosura në Planin e zhvillimit të Qëndrueshem të Komunitetit të Bulqizës për vitin 2012-20130 që është miratuar në vitin 2013

Titulli/Emërtimi i projektit	Ndërtim thertorje në Bulqizë
Tipi i projektit	Infrastrukturë shërbimi
Vendndodhja e projektit	Qyteti Bulqizë
Buxheti total i projektit	8 000 000 ALL
Kontributi në rastin e bashkëfinancimit nga qeveria vendore	20 % Bashkia

Pershkrimi i projektit	Në qytetin e Bulqizës aktualisht ndodhen 5-6 thertore të vogla të cilat janë të vendosura në rrugët kryesore dhe dytesore të qytetit. Pranë këtyre thertoreve çdo ditë kemi ekspozim të bagëtive që do të theren gjithashtu kasapët bëjnë therjen bagëtive dhe shitjen e mishit në të njëtin vend. Në pika të tjera të qytetit dhe në shumë vende të tjera të bashkisë therja e bagëtive behet në natyre, jashtë kontrollit veterinar. Kjo praktikë jo vetëm afron një praktikë shumë keqe shërbime ndaj qytetarëve por gjithashtu është një rrezik i përditshëm për përhapjen e sëmundjeve. Nëpërmjet këtij projekti synohet përqëndrimi i therjes së bagëtive në një vend me kontroll veterinar dhe higjieno-sanitar të vazhdueshëm dhe shitja e mishit të bëhet në duqane që plotësojnë standartet bashkëhore të tregtimit të mishit dhe nën produkteve të tij.
Qëllimi dhe objektivat	Qëllimi i projektit është rritja e sigurisë ushqimore, me objektiv <ul style="list-style-type: none"> ▪ Përmirësimi i standarteve të therjes dhe tregtimit të mishit. ▪ Rritja e cilësisë së shërbimit ndaj qytetarëve. ▪ Rritja e të ardhurave të bashkisë
Rezultatet e pritshme	Ndër rezultatet e pritshme janë: <ul style="list-style-type: none"> ▪ Një thertore sipas standarteve e ndërtuar ▪ Standarte therjes dhe tregtimit të mishit të përmisuara ▪ Siguria ushqimore e përmisuar ▪ Mjedis i përmisuar
Rendi prioritar	Projekti është në rendi prioritar 1
Qendrueshmeria e projektit	Për administrimin dhe mirëmbajtjen e thertoresh do të krijohet një fond nga të tarifata e shërbimit veterinar, higjieno-sanitar dhe nga taksa për therjen e bagëtive. Gjithashtu do të krijohet një rrjet mes thertoresh dhe duqaneve të tregtimit të mishit. Mënyra e krijimit dhe e përdorimit të këtij fondi do të rregullohet një rregullorje të miratuar nga këshilli i bashkisë.
Aktivitetet e projektit	Për realizimin e projektit janë të nevojshëm: <ul style="list-style-type: none"> ▪ Studimi i gjendjes dhe e fizibilitetit. ▪ Raporti i ndikimit në mjedis ▪ Gjetjen e truallit ▪ Hartimi i projektit teknik ▪ Ngritja e skemave të partneritetin publik privat ▪ Miratimi i lejeve administrative. ▪ Zbatimi dhe monitorimi i projektit
Vlerësimi i ndikimit në mjedis	Nuk ka një raport vlersimi për ndikimin në mjedis
Përshkrim për gatishmërinë e projektit për zbatim.	Projekti ndodhen në fazën e projekt ides. Ka një vullnet nga autoritet e Bulqizës për të përmisuar dhe rrit sigurinë ushqimore.
Planifikimi vendor, ndërvendor, kombëtar	Projekti nuk ka qenë i parashikuar në ndonjë document strategjik të mëparshëm.

Titulli/Emërtimi i projektit	Rikonstrukcion shkolla 9-vjeçare Sopot
Tipi i projektit	Infrastruktura arsimore
Vendndodhja e projektit	Njësia administrative Zerqan
Buxheti total i projektit	9 535 000 ALL
Kontributi në rastin e bashkëfinancimit nga qeveria vendore	Bashkia 2 %

Përshkrimi i projektit	Në shkollën 9-vjeçare Sopot ndjekin mësimin rreth 300 nxënës. Godina e shkollës ka pësuar demtime në suvatime, mure, dritare, dyer dhe banka. Ka lind nevoja për një përmirësim apo rikonstruksion i plotë.
Qëllimi dhe objektivat	Qëllimi i projektit është përmirësimi dhe modernizimi i arsimit, me objektiv <ul style="list-style-type: none"> ▪ Krijimin e një mjedisi të përshatshëm për procesin mësimor ▪ Rritjen e interesit të nxënësve për të ndjekur shkollën ▪ Ndërgjegjësimin e nxënësve dhe personelit mësimdhënës për mirëmbajtjen e shkollës ▪ Rritjen e kapaciteteve të qeverisjes vendore për administrimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës shkollore
Rezultatet e pritshme	Rezultatet e pritshme të projektit janë <ul style="list-style-type: none"> ▪ Mjedis fizik i përshtatshëm për 300 nxënës ▪ Cilësia e mësimdhënies dhe mësimnxënies e përmirësuar ▪ Ndërgjegjësimi i nxënësve, mësuesve dhe prindërve për mirëmbajtjen e shkollës. ▪ Kapacitete të përmirësuara të qeverisjes vendore për administrimin dhe mirëmbajtjen e shkollave
Rendi prioritar	Projekti është në rendin prioritar 1
Qendrushmeria e projektit	Pranë bashkisë do të ngrihet një njësi e administrimit dhe mirëmbajtjes së infrastrukturës shkollore, e cila në bashkëpunim me komunitetin e prindërve, mësuesve dhe nxënësve do të sigurojnë një qendrushmëri të mirë dhe afatgjatë të projektit.
Aktivitetet e projektit	Për realizimin e projektit janë të nevojshëm: <ul style="list-style-type: none"> ▪ Vlerësimi i gjendjes aktuale ▪ Hartimi i projektit teknik ▪ Sigurimi i lejeve administrative ▪ Aplikimi tek ndonjë donator ▪ Zbatimi i projektit
Vlerësimi i ndikimit në mjedis	Projekti nuk ka ndikim në mjedis
Përshkrim për gatishmërinë e projektit për zbatim	Projekti ndodhen në fazën e projekt idesë.
Planifikimi vendor, ndervendor, kombëtar	Projekti nuk ka qenë i parashikuar në ndonjë document strategjik të mëparshëm

Titulli/Emërtimi i projektit	Rikonstruksion i Shkollës I. Daci Shupenze
Tipi i projektit	Infrastruktura arsimore
Vendndodhja e projektit	Njësia administrative Shupenzë
Buxheti total i projektit	9 535 000 ALL
Kontributi në rastin e bashkëfinancimit nga qeveria vendore	Bashkia 2 %
Përshkrimi i projektit	Shkolla I. Daci Shupenzë është në shërbim të 420 nxënësve dhe 26 mësuesve. Godina e shkollës ka pësuar demtime në suvatime, mure, dritare, dyer dhe banka. Gjendja në të cilën ndodhet godina është një pengesë serioze për mësimdhënien dhe mësimnxënien. Është vlersuar si prioritet për vitin 2016 përmirësimi apo rikonstruksion i plotë.

Qëllimi dhe objektivat	<p>Qëllimi i projektit është përmirësimi dhe modernizimi i arsimit, me objektiv</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Krijimin e një mjedisi të përshatshëm për procesin mësimor ▪ Rritjen e interesit të nxënësve për të ndjekur shkollën ▪ Ndërgjegjësimin e nxënësve dhe personelit mësimdhënës për mirëmbajtjen e shkollës ▪ Rritjen e kapaciteteve të qeverisjes vendore për administrimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës shkollore
Rezultatet e pritshme	<p>Rezultatet e pritshme të projektit janë</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Mjedis fizik i përshtatshëm për 420 nxënësve dhe 26 mësuesve ▪ Cilësia e mësimdhënies dhe mësimnxënies e përmirësuar ▪ Ndërgjegjësimi i nxënësve, mësuesve dhe prindërve për mirëmbajtjen e shkollës. ▪ Kapacitete të përmirësuara të qeverisjes vendore për administrimin dhe mirëmbajtjen e shkollave
Rendi prioritar	Projekti është në rendin prioritar 1
Qendrushmeria e projektit	Pranë bashkisë do të ngrihet një njësi e administrimit dhe mirëmbajtjes së infrastrukturës shkollore, e cila në bashkëpunim me komunitetin e prindërve, mësuesve dhe nxënësve do të sigurojnë një qendrushmëri të mirë dhe afatgjatë të projektit.
Aktivitetet e projektit	<p>Për realizimin e projektit janë të nevojshëm:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Aplikimi tek Fondi i Rajoneve apo tek ndonjë donator tjetër ▪ Miratimi i lejeve administrative. ▪ Zbatimi i projektit
Vlerësimi i ndikimit në mjedis	Projekti nuk ka ndikim në mjedis
Përshkrim për gatishmërinë e projektit për zbatim	Projekti për rikonstruksionin e shkollës është i hartuar dhe ndodhet në Bashki me të gjithë specifikimet teknike, relacion, preventiv dhe projekt zbatim
Planifikimi vendor, ndervendor, kombëtar	Projekti nuk ka qenë i parashikuar në ndonjë document strategjik të mëparshëm

Titulli/Emërtimi i projektit	Ri-konstruksioni i Shkollës së Mesme Shupenzë
Tipi i projektit	Infrastruktura arsimore
Vendndodhja e projektit	Njësia administrative Shupenzë
Buxheti total i projektit	22 500 000 ALL
Kontributi në rastin e bashkëfinancimit nga qeveria vendore	Bashkia 2 %
Përshkrimi i projektit	Shkolla Mesme Shupenzë është një godinë tre katëshe e cila prej vitesh nuk është përfshirë në rikonstruksion. Godina e shkollës ka pësuar demtime në suvatime, mure, dritare, dyer dhe banka. Gjendja në të cilën ndodhet godina është një pengesë serioze për mësimdhënien dhe mësimnxënien. Është vlersuar si prioritet për vitin 2016 përmirësimi apo rikonstruksion i plotë.. Godina është në shërbim të 400 nxënës dhe 21 mësues.

Qëllimi dhe objektivat	<p>Qëllimi i projektit është përmirësimi dhe modernizimi i arsimit, me objektiv</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Krijimin e një mjedisi të përshatshëm për procesin mësimor ▪ Rritjen e interesit të nxënësve për të ndjekur shkollën ▪ Ndërgjegjësimin e nxënësve dhe personelit mësimdhënës për mirëmbajtjen e shkollës ▪ Rritjen e kapaciteteve të qeverisjes vendore për administrimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës shkollore
Rezultatet e pritshme	<p>Rezultatet e pritshme të projektit janë</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Mjedis fizik i përshtatshëm për 400 nxënës dhe 21 mësues ▪ Cilësia e mësimdhënies dhe mësimnxënies e përmirësuar ▪ Ndërgjegjësimi i nxënësve, mësuesve dhe prindërve për mirëmbajtjen e shkollës. ▪ Kapacitete të përmirësuara të qeverisjes vendore për administrimin dhe mirëmbajtjen e shkollave
Rendi prioritar	Projekti është në rendin prioritar 1
Qendrueshmeria e projektit	Pranë bashkisë do të ngrihet një njësi e administrimit dhe mirëmbajtjes së infrastrukturës shkollore, e cila në bashkëpunim me komunitetin e prindërve, mësuesve dhe nxënësve do të sigurojnë një qendrueshmëri të mirë dhe afatgjatë të projektit.
Aktivitetet e projektit	<p>Për realizimin e projektit janë të nevojshëm:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Aplikimi tek Fondi i Rajoneve apo tek ndonjë donator tjetër ▪ Miratimi i lejeve administrative. ▪ Zbatimi i projektit
Vlerësimi i ndikimit në mjedis	Projekti nuk ka ndikim në mjedis
Përshkrim për gatishmërinë e projektit për zbatim	Projekti për rikonstruksionin e shkollës është i hartuar dhe ndodhet në Bashki me të gjithë specifikimet teknike, relacion, preventiv dhe projekt zbatim
Planifikimi vendor, ndervendor, kombëtar	Projekti nuk ka qenë i parashikuar në ndonjë document strategjik të mëparshëm

